

ISSN 1857-6443  
9 771857 644006

## Zaev & Vuçiq

Interesa të përbashkëta me Serbinë

Fq.5



## 109 VJETORI I ALFABETIT

Kongresi që ndryshoi rrjedhat e historisë

Fq.4



Të vazhdojmë serinë e fitoreve

## Berisha

Fq.19



# Koha 11 VJET ME JU

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XI · Numri 3228 · E mërkurë-e enjte 22-23 nëntor 2017

-2°C | +10°C

15 DEN

### EDITORIAL

KOHA 11 vjet, gazetë e të vërtetave dhe e vlerave të lirisë!



Sot, gazeta KOHA mbush 11 vjet. Ky përvjetor i 11-të i KOHËS është jo veç një festë e jona, por një festë e fjalës së lirë, e informimit objektiv, një festë që për thelb ka të gjitha liritë e garantuara me ligje dhe Kushtetutë. Fq.2

### DOSSIER

Një vatër e ngritjes së vetëdijes kombëtare

Fq.16-17

### RAJON

Kudo ku ka shkelur çizmja e Milladiqit, është bërë gjenocid

Fq.14



## DY PARTITË MAQEDONASE "MËSHIROHEN" ME KOMUNITETET TJERA

# EDHE LSDM KUNDËR FJALËS "GJUHA SHQIPE"



Përcaktimi i fjalës "gjuha shqipe" në kllapa në paragrafin 2 të nenit 1 të Ligjit për gjuhët dhe ajo që në opinion e gjerë po njihet si Ligj për avancimin zyrtar të gjuhës shqipe, jo vetëm VMRO-së opozitare, por edhe LSDM-së në pushtet duket që i pengon. Të dyja partitë maqedonase me amendamente propozojnë të theksojnë edhe gjuhët e komuniteteve tjera, ndërsa kërkojnë të ulet dënimi për Institucionet që nuk e respektojnë përdorimin e drejtë të shqipes Fq.3

## Shuhet ideja për Akademinë e Mësuesve

Shkup, 21 nëntor - Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), sipas të gjitha gjasave ka hequr dorë nga themelimi i Akademisë së Mësuesve, e cila u lansua vite përpara si mekanizëm, me të cilin MASH synonte të vjen deri të rritja e cilësisë së mësimdhënies nëpër shkollat fillore dhe të mesme.

Përmes kësaj Akademie, Qeveria e përparshme, e kryesuar nga VMRO-ja, pretendonte se do

të sigurohet mekanizmi për përgatitjen e mësimdhënësve kualitativ, mirëpo as në kohën e asaj qeverie nuk u ndërmoren hapa konkret për jetësimin e idesë për themelimin e Akademisë së Mësuesve. Madje, u ndryshuan dy herë afatet ligjore për fillimin me punë të kësaj Akademie, e cila do të liçensonte të gjithë kuadrot me përgatitje profesionale para se të fillonin punë si mësimdhënës. Fq.7



## EDITORIAL

# KOHA 11 VJET, GAZETË E TË VËRTETAVE DHE E VLERAVE TË LIRISË!



Vedat MEMEDALIU  
kryeredaktor

**S**ot, gazeta KOHA mbush 11 vjet. Ky përvjetor i 11-të i KOHËS është jo veç një festë e jona, por një festë e fjalës së lirë, e informimit objektiv, një festë që për thelb ka të gjitha liritë e garantuara me ligje dhe Kushtetutë.

Është një festë sepse arritëm atë që të tjerët nuk po e bëjnë dot. Katër herë renditemi e para në matjet e institucioneve ndërkombëtare për lexueshmëri, objektivitet dhe për krijim të saktë të opinionit. Jo vetëm tek mediat shqipe, por tejkaluam edhe mediat maqedonase.

Analistë, politikanë, aktivistë të shoqërisë civile, qytetarë... për 11 vjet kanë qenë pjesë e faqeve të KOHËS. Edhe shumë gazetarë që sot drejtojnë institucione, media dhe organizata tjera ishin po ashtu pjesë e jona. KOHA për gjithë këto vite arriti të ketë fuqinë e joshjes së masave të gjera të lexuesve, me të cilën po rritet një brez i tërë. Arriti të gjejë vendin e merituar edhe në hapësirën e internet-portaleve, në një vijë të drejtë me gazetën e shtypur.

Pozicioni këmbëngulës dhe i pakompromis i gazetës KOHA ka qenë dhe mbetet zgjidhja e vetme në kushtet kur shtypi po përballet me probleme të llojllojshme si editoriale, autonomisë ekonomike dhe problemeve të karakterit logjistik. Madje, edhe më fort do t'i mbrojmë këto sfida si gazetë që tashmë 11 vjet është e pranishme në tregun e shtypit, një institucion që burimin primar ka problemin shqiptarë jo vetëm në Maqedoni, por gjithandej ku frymohet shqip.

Ishim dhe mbetemi kujdestarë të proceseve demokratike, me rol të rëndësishëm në zhvillimin e institucioneve të brishta të vendit dhe proceseve të tjera me interes kombëtar dhe shtetëror.

KOHA është e Juaja, e gjithë atyre që për çdo ditë vendosin të informohen nga ne, nga gazeta që për 11 vite nuk mungoi as edhe një ditë të vetme. Dhe ne sigurojmë në vazhdimin e rrugës që kur numri i parë i gazetës - 22 nëntor 2006, preku duart Tuaja - do jemi korrektues dhe kritikues i të gjitha veprimtarive institucionale vendore dhe ndërkombëtare, kur ato nuk janë në linjë me interesat shqiptarë dhe ato shtetëror.

## Kur Kali i Trojës të kthen nga fillimi...

"Mundohesh, lodhesh, përpiqesh të informosh, edukon në dalje televizive, flet për gjëra që shumë nuk kanë guxim as edhe ti çojnë nëpër mend a jo më ti flasin. Krejt këto pa asnjë interes dhe me shumë sakrificë personale (dhe familjare), por me qellim që populli im të informohet drejt për të gjithë devijimet, deformimet dhe të këqijat që i bëhen duke bërë me gisht për to. Për këtë shantazhohesh, kërcënohesh, të frikësojnë me jetë dhe kur mendon se, për një çast, ama vetëm për një çast, që ja ke arritur qëllimin që sado pak t'i lëvizësh gjërat në drejtim pozitiv - deli Kali i Trojës dhe të kthen krejt në fillim dhe pyet veten: A ja vlen kjo luftë?", shkruan në Facebook analisti Visar Ademi.



## Emigrantët dhe terroristët

"Kur dëgjon shërbimet tona si nxjerrin vrer në konferenca për emigrantet, do të mendosh se 1.000.000 terroristë janë futur në vend. Atëherë, të mos na habisë qëndrimi dhe sjellja e tyre ndaj qytetarëve tanë, të cilët përcillen me shumicë, përgjohen, u lexohen porositë dhe meilet, mbahen nëpër kufij dhe u jepen informacione personale prezervativ gazetarëve dhe mediave që t'i njollosin të njëjtit. Pa reformë të udhës, më mirë është të shuhet shërbimet e këtilla, sesa të punojnë kundër qytetarëve, sepse edhe ashtu një kohë të gjatë nuk janë në shërbim të qytetarëve", shkruan në profilin e tij në Facebook aktivisti Jasmin Rexhepi.



## Miku i madh, Eliot Engel

"Sot, kisha një mëngjes të hershëm pune me Kongresmenin Eliot Engel, zërin më të fuqishëm dhe përkrahësin më të madh të shqiptarëve të Kosovës në SHBA. Diskutuam shumë çështje të proceseve politike nëpër të cilët po kalon vendi ynë. Mbi shtimin e përpjekjeve të reja amerikane për konsolidimin e mëtejshëm të shtetit të Kosovës si nga brenda ashtu edhe nga jashtë. E falënderova në veçanti kongresistin Engel për programin Korporata Sfidat e Mijëvjeçarit (MCC), i cili do t'i sjellë vendit tonë 49 milionë euro investime dhe shumë vende të reja pune. Njeriu më meritues për shtyrjen përpara të këtij programi ka qenë Kongresmeni, Eliot Engel dhe Shefi i Stafit të Demokratëve në Komitetin mbi Marrëdhënie me Jashtë z. Jason Steinbaum. Është vërtetë kënaqësi dhe nder i madh që vendi dhe populli ynë ka miq kaq të mëdhenj dhe modest si Kongresmeni Engel", shkruan zëvendëskryeministri i Kosovës, Behgjet Pacolli në Facebook.



## Ngushtohuni se paska vend!

"Me përfundimin e zgjedhjeve po vjen edhe kontingjenti më i ri i zëvendësministrave. Kishin mbetur edhe dy ministri me nga vetëm 1 zëvendësministër. Tash ia bëjnë si me kerret - veç me shofer që shkojnë për t'i marrë nuset: Hajde ngushtohuni qetu edhe 3-4 veta se paska vend!", shkruan Adriatik Kelmendi, kryeredaktor i KOHA Vizionit.



## MEDIACitate

Igor Simiq deputet i Listës Serbe në Kuvendin e Kosovës dhe zëdhënës i këtij subjekti politik, thotë për Radion Evropa e Lirë se dominimi i Listës Serbe në zgjedhjet parlamentare karshi subjekteve tjera serbe, fitorja në zgjedhjet lokale në 10 komunitet me shumicë serbe, si dhe arritja e qëllimit që të ketë këshilltarë komunalë në 7 komuna të tjera, ku serbët nuk janë shumicë, janë tregues të fuqisë së këtij subjekti politik. "Mund të them se me Listën Serbe, serbët kanë fituar një korpus politik unik, i cili do të luftojë për një jetesë më të mirë të serbëve në këto hapësira. Mund të them se kjo është fitore e popullit serb". (Radio Evropa e Lirë, 21 nëntor)

Presidenti i Çekisë, Milosh Zeman, e ka quajtur 'praktikë të keqe' politikën e "dy kuteve" të BE-së kur bëhet fjalë për pavarësinë e Kosovës dhe aneksimin e Krimesë Rusisë.

"Nga njëra anë është Kosova, ku Kombet e Bashkuara ishin garant, por ai garancion nuk ishte siguruar, e tash në anën tjetër - Krimea, ku është mbajtur referendumi. Këto janë dy standarde dhe kjo është keq", e citon atë agjencia ruse e lajmeve, TASS. (TASS, 21 nëntor)



Kryeministri Rama ka postuar foton e një avioni civil, mbi trupin e të cilit shkruhet "Air Albania", ndërsa e ka shoqëruar postimin me diçiturën "Së shpejti", pasuar nga një flamur shqiptar. Rama duket se i referohet krijimit të një linje shqiptare fluturimesh, që kishte njoftuar pranverën e kaluar, kur u takua me përfaqësues të "Turkish Airlines", kompani e cila do të ndihmonte në këtë drejtim. Ajo që bie në sy nga foto e postuar prej Ramës është dominimi i ngjyrave kuq e zi. Ndërsa në bishtin e avionit, tërheqin vëmendjen disa linja që duket se rikrijnë krahët e shqiponjës, që mbizotëron flamurin shqiptar. Në këtë ngacim fotografik, Kryeministri nuk ka bërë publike një datë kur do të nisë fluturimet "AirAlbania", duke na lënë të gjithëve në pritje. (TV KLAN, 21 nëntor)

## NËSE NUK E KENI DITUR...

### Cila është historia e Dibrës?

Dibra për herë të parë përmendet në hartën e Ptolemeut (shek. II e.s.) me emrin Deburus. Më 1502 njihet si qendër e rëndësishme qytetare. Në vitet 30-40 të shek. XIX, Dibra me afro 8400 banorë dhe 250 dyqane, ishte një nga qendrat më të rëndësishme ekonomike të tregut të brendshëm shqiptar. Dibra ka qenë një nga vatrave e qëndrës kundër pushtuesve të ndryshëm dhe dha një ndihmesë të veçantë në luftërat shqiptaro-osmane nën udhëheqjen e Skënderbeut. Qyteti dhe rrethet e tij

luajtën një rol të rëndësishëm në lëvizjen kombëtare të udhëhequr nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Këtu u mbajt edhe Kuvendi i Dibrës (1878) që miratoi programin e Lidhjes. Në vitin 1900 u hap shkolla e parë shqipe. Popullsia e Dibrës u bëri qëndrësë të fortë trupave pushtuese serbe më 1912 dhe kundërshtoi aneksimin e kësaj krahine nga Mbretëria serbe. Në shtator 1913 u bë qendra kryesore e kryengritjes antiserbe, që u përhap nga Gjakova deri në Ohër.



## DY PARTITË MAQEDONASE "MËSHIROHEN" ME KOMUNITETET TJERA



# EDHE LSDM KUNDËR FJALËS "GJUHA SHQIPE"

Përcaktimi i fjalës "gjuha shqipe" në kllapa në paragrafin 2 të nenit 1 të Ligjit për gjuhët dhe ajo që në opinion e gjerë po njihet si Ligj për avancimin zyrtar të gjuhës shqipe, jo vetëm VMRO-së opozitare, por edhe LSDM-së në pushtet duket që i pengon. Të dyja partitë maqedonase me amendamente propozojnë të theksojnë edhe gjuhët e komuniteteve tjera, ndërsa kërkojnë të ulen dënimi për Institucionet që nuk e respektojnë përdorimin e drejtë të shqipes

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 21 nëntor - Ligji për përdorimin e gjuhëve të mërkurën do të jetë pikë e vetme e diskutimit në Komisionin për çështje evropiane, ndërsa për Ligjin në fjalë - partitë politike kanë propozuar gjithsej 90 amendamente, mes tyre VMRO 83, LSDM 4 dhe 2 Lëvizja BESA. Por, përcaktimi i fjalës "gjuha shqipe" në kllapa në paragrafin 2 të nenit 1 të Ligjit për gjuhët dhe ajo që në opinion e gjerë po njihet si Ligj për avancimin zyrtar të gjuhës shqipe, jo vetëm VMRO-së opozitare, por edhe LSDM-së në pushtet duket që i pengon. Të dyja partitë - VMRO dhe LSDM në amendamente pothuajse të njëjta kanë propozuar ti theksojnë edhe komunitetet tjera - VMRO veç e veç, ndërsa LSDM kërkon të ceket Preambula kur bëhet fjalë për gjuhët e komuniteteve që jetojnë në Maqedoni. Koordinatori I grupit parlamentar të LSDM-së, Tomisllav Tuntev, nuk specifikoi se për cilin paragraf kanë kërkuar ndërhyrje - për paragrafin 2 ku ceket "gjuha shqipe" në kllapa apo paragrafin 4 - kur specifikohet përdorimi i gjuhës që flasin mbi 20 për qind në pushtetin lokal. Në pyetjen e gazetës KOHA nëse do të kërkojnë të hiqet termi "gjuha shqipe" në kllapa apo të shtohen gjuhët tjera në paragrafin 2, Tomisllav Tuntev tha vetëm se "nuk mund të

them konkretisht tash me nene, por nuk dëmtohet gjuha shqipe, por se shtohen edhe gjuhët tek komuniteteve tjera siç është cekur në preambulën e Kushtetutës". Krahas kësaj, siç njoftoi Tuntev, LSDM ka propozuar që të ulen dënimet nga 5 mijë euro në 2 mijë euro për Institucionin që nuk e zbaton këtë Ligj, dhe atë që funksionarët shtetëror që nuk janë maqedonas, të kenë të drejtën të shprehen në cilën gjuhë duan ata. "Me këtë Ligj duam të rregullohen të drejtat edhe të komuniteteve tjera, konkretisht gjuhët të cilën ata e flasin në pajtim me Preambulën e Kushtetutës së Maqedonisë. Amendament tjetër kemi uljen e dënimeve nga 4 deri në 5 mijë siç thuhet në propozim-ligj, në 2 mijë euro. Propozojmë edhe atë që ministrat dhe funksionarë tjerë shtetëror të kenë të drejtën të shprehen në cilën gjuhë duan ata, do të thotë nga gjuhët e komuniteteve që jetojnë në Maqedoni e jo të kufizohen vetëm në gjuhën së cilës i takojnë si komunitet", theksoi Tuntev. Në pyetjen e gazetareve nëse do të pranojnë propozimin e VMRO-së që të hiqet shenja e BE-së, koordinatori i LSDM-së tha se Ligji për gjuhët nuk mund të kthehet në fillim, sepse siç u shpreh ai, është Ligji i fundit i ligjeve që del nga Marrëveshja e Ohrit. "Ky ligj është ligj për përdorimin e gjuhëve e jo ligj për gjuhën

shqipe, siç deshi dikush ta interpretojë", tha Tomisllav Tuntev. Kujtojmë se Tuntev në disa raste, kur gazetarët shqiptarë gjatë pyetjeve theksonin termin "ligji për shqipen", në çdo rast Tuntev theksonte se ky Ligj nuk është për përdorimin e shqipe, por është ligj për përdorimin e gjuhëve, ndonëse në Maqedoni vetëm shqiptarët janë komuniteti që përbëjnë mbi 20 % të popullsisë krahas komunitetit maqedonas.

Ndërkaq VMRO, përveç që kërkon që të hiqet shenja e BE-së dhe për Ligjin të hapet debat publik, me 83 amendamentet që ka dorëzuar kërkon që dokumentet zyrtare jo vetëm në Qeveri, por dhe në gjykata të mos jenë në dy gjuhë kur pala është shqiptar, por ato të jenë vetë në gjuhën maqedonase, por që të përkthehen në gjuhën e palës së interesuar. Përveç kësaj, VMRO kërkon që të hiqet neni 1 - paragrafi 2, ku specifikohet "gjuha shqipe" dhe të shtohen edhe "gjuha turke, rome, serbe, boshnjake dhe vllehe". Sa i përket gjobave, VMRO kërkon uljen drastike nga 4 deri në 5 mijë euro në 400 deri në 500 euro për institucionet që nuk e zbatojnë Ligjin. Në gazetën zyrtare, VMRO propozon që të gjitha shkresat të jenë vetëm në gjuhën maqedonase, por të përkthyer edhe në gjuhën shqipe. Drejtorin e Agjencisë së Përkthyesve, VMRO kërkon ta emërojë Parlamenti e jo Qeveria,

siç thuhet në propozim-ligj. Gjithashtu, dhe çdo dokument tjetër zyrtar të përkthehet në gjashtë gjuhë e jo vetëm në gjuhën shqipe.

Paraprakisht, deputeti i VMRO-së, Ilija Dimovski para gazetareve tha se kërkesa e tyre që Ligjit ti hiqet shenja e BE-së dhe të hapet debat i gjerë publik duhet të mbështetet sidomos tani, pasi dje vet komisarari për zgjerim i BE-së, Johannes Han se Ligji për gjuhët nuk qëndron në kushtet kryesore që duhet përmbushur vendi për hapje të negociatave me BE-në. Ndryshe, Neni 1 paragrafi 2 i propozim-ligjit për gjuhët thotë se "gjuhë tjetër që e flasin mbi 20 për qind e qytetarëve (gjuha shqipe), gjithashtu është gjuhë zyrtare dhe alfabeti e saj sipas këtij Ligji". Meqë ka shenjën e BE-së, debati në këtë Komision është i kufizuar në vetëm tre ditë, dhe me pas të kalojë në seancë plenare për lexim të dytë, ku debati nuk është i kufizuar, por deputetët nuk kanë të drejtë të intervenojnë me amendamente, por pas përfundimit të debatit - deputetët mund të votojnë "pro" dhe "kundër" Ligjit. Është e pritshme që deputetët e VMRO-së të shfrytëzojnë këtë dhe të kërkojnë diskutime, replika dhe kundër-replika mes vete ashtu siç bënë edhe në seancën për votimin e Qeverisë, kjo për të bllokuar me muaj Ligjin për përdorimin e gjuhëve.



TOMISLLAV TUNTEV

Me këtë Ligj duam të rregullohen të drejtat edhe të komuniteteve tjera, konkretisht gjuhët të cilën ata e flasin në pajtim me Preambulën e Kushtetutës së Maqedonisë. Amendament tjetër kemi uljen e dënimeve nga 4 deri në 5 mijë siç thuhet në propozim-ligj, në 2 mijë euro. Propozojmë edhe atë që ministrat dhe funksionarë tjerë shtetëror të kenë të drejtën të shprehen në cilën gjuhë duan ata, do të thotë nga gjuhët e komuniteteve që jetojnë në Maqedoni e jo të kufizohen vetëm në gjuhën së cilës i takojnë si komunitet



Deputeti i VMRO-së, Ilija Dimovski para gazetareve tha se kërkesa e tyre që Ligjit ti hiqet shenja e BE-së dhe të hapet debat i gjerë publik duhet të mbështetet sidomos tani, pasi dje vet komisarari për zgjerim i BE-së, Johannes Han se Ligji për gjuhët nuk qëndron në kushtet kryesore që duhet përmbushur vendi për hapje të negociatave me BE-në



## BESA KËRKON TË NDRYSHOHET TITULLI I LIGJIT

Kur jemi tek titullimi i Ligjit, deputeti i Lëvizjes BESA, Afrim Gashi ka thënë se me amendamente kanë propozuar pikërisht ndryshimin e titullit të Ligjit nga "Ligji për përdorimin e gjuhëve" të quhet "Ligj për përdorimin e gjuhës shqipe", dhe amendament tjetër që gjuha shqipe të jetë gjuhë zyrtare bashkë me gjuhën maqedonase në të gjithë territorin e vendit.

AKADEMI KUSHTUAR 109 VJETORIT TË KONGRESIT TË MANASTIRIT

# KONGRESI QË NDRYSHOI RRJEDHAT E HISTORISË

"Historia kombëtare shqiptare është përplot me ngjarje madhështore, me ngjarje që kanë peshë të madhe, që shënojnë pikë kthese në zhvillimin e kombit, në rrugëtimin e tij civilizues dhe bashkëkohor...", tha Lika

Manastir, 21 nëntor - Me prezencën e presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, zëvendëskryeministrit Hazbi Lika, kryetares së Komunes së Manastirit, Natasha Petrovska, ambasadorëve, drejtuesve të instituteve albanologjike të Shkupit, Tiranës e Manastirit, dhe studiuesve të shumtë, dje në Manastir u hap tribuna shkencore kushtuar 109 vjetorit të Kongresit të Alfabetit të Shqipërisë dhe 10-vjetorit të themelimit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup. Zëvendëskryeministri i Maqedonisë përgjegjës për zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit dhe sistemit politik, Hazbi Lika në fjalën e tij në hapjen e Tribunës u shpreh se Kongresi i Alfabetit mbetet një nga veprimet strategjike ekzistenciale për ngritjen e vetëdijes në rrafshin kombëtar dhe për përforcimin e identitetit kulturor. "Historia kombëtare shqiptare është përplot me ngjarje madhështore, me



ngjarje që kanë peshë të madhe, që shënojnë pikë kthese në zhvillimin e kombit, në rrugëtimin e tij civilizues dhe bashkëkohor. Një ndër këto ngjarje historike dhe kulturore është edhe Kongresi i Alfabetit të gjuhës shqipe i mbajtur pikërisht në këtë qytet, si njëri nga

qendrat administrative e kulturore në atë kohë dhe një qendër e një shembulli të një bashkëjetese mes komuniteteve në kohën e sotshme i cili duhet të grumbullojë fuqi, të marrë guxim dhe të mbajë përgjegjësi për krijimin e kushteve për të gjithë qytetarët në mënyrë të

barabartë. Kongresi i Alfabetit mbetet një nga veprimet strategjike ekzistenciale për ngritjen e vetëdijes në rrafshin kombëtar dhe për përforcimin e identitetit kulturor", tha Lika. Ai më tej theksoi se ky Kongres ka rëndësi të madhe pasi është një hap vendimtar drejt

hapjes së shtigjeve për realizimin e synimeve të qytetarëve për ngritjen sa më të lartë të vetëdijes kulturore dhe nacionale, ndërsa në anën tjetër ky Kongres ishte në funksion të pjekurisë së lartë kombëtare të popullit shqiptar. "Alfabeti unik i shqiptarëve, pa dallim të përkatësisë rajonale- krahinore apo fetare është simbol i identitetit të përbashkimit, ndërsa kësaj ngjarje i paraprin shumë zhvillime politike, ekonomike dhe arsimore. Formësimi i Alfabetit të Gjuhës Shqipe nuk ishte vetëm fenomen gjuhësor, por ishte veprim i urtë politik në drejtim të rrafshimit të dallimeve mes shqiptarëve, por edhe zgjimit të tyre në dimensionin kombëtar, ndërsa për këtë ngjarje u angazhuan shume intelektuale, klube e shoqëri kulturore shqiptare të asaj kohe. Vendimet e Kongresit të Manastirit janë historike në aspektin gjuhësor dhe kulturor", tha Lika.

## META: KONGRESI PËRSHPEJTOI PAVARËSINË E SHQIPËRISË

Kongresi i Manastirit, Dita e Alfabetit, 22 nëntori është një nga datat më të mëdha të historisë shqiptare, moment kyç përbashkues që e orientoi kombin shqiptar drejt kombeve më të përparuara të botës perëndimore, tha presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta në tribunën shkencore të mbajtur sot në Manastir në kuadër të 109 vjetorit të Kongresit të Manastirit. "Në këtë mënyrë jo vetëm forcojmë e ruajmë vlerat tona më të mira, por edhe bashkëjetesën midis vendeve, popujve dhe në këtë rast dua të falënderoj qeverinë e Maqedonisë për kujdesin për këtë ngjarje", tha Meta. Sipas Metës Kongresi i Manastirit është

një ngjarje shumë e rëndësishme sepse e përshpejtoi mbajtjen e ngjarjes akoma edhe më të rëndësishme, pavarësinë e Shqipërisë". "Me këtë Alfabet u shkrua dokumenti i pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912, u nënshkrua deklarata e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, me këtë Alfabet u shkrua shqip edhe Marrëveshja e Ohrit e 13 gushtit më 2001...", ka nënvizuar Meta dhe publikisht i falënderoi nënkryeministrit Hazbi Lika dhe kryetaren e Manastirit, Natasha Petrovska për kujdesin që tregojnë për muzeun dhe për të gjitha planet për restaurimin dhe pasurimi e Muzeut.

EUROKOMISARI PËR ZGJERIM VAZHDON VIZITËN NË SHKUP

## HANI KËRKON MBËSHTETJE NGA TË GJITHË

Shkup, 21 nëntor - Komisarja evropiane për Zgjerim dhe Fqinjësi të Mirë, Johan Han, dje në Shkup theksoi se një ndër qëllimet kryesore të vizitës së tij është që ta potencojë interesin e vazhdueshëm të Brukselit për ngjarjet në vend, por edhe të marrë bindje se edhe pushteti edhe opozita janë plotësisht të përkushtuar në procesin eurointegrues dhe në gjithçka që nevojitet të punohet në atë drejtim. Han duke u përgjigjur në pyetjet e gazetarëve lidhur me atë pse ka kërkuar takim me liderin e VMRO-DPMNE-së opozitare, Nikolla Gruevski, por edhe me liderët e BESËS dhe PDSH-së, tha se BE ka investuar shumë në Maqedoni, ka menaxhuar shumë situata dhe se hapi i ardhshëm është fokusi i plotë i proceseve urgjente të reformave. "Nevojitet që të miratohen të gjitha ligjet në fushat e jurisprudencës,



zbulimit dhe administratës publike, që është kyçe që të merret rekomandim pozitiv nga BE. Shpresojmë se kjo do të ndodhë diku nga shkurti, me shpresë se negociatat do të fillojnë vitin e ardhshëm. Ky është qëllimi ynë dhe për këtë u takova edhe me opozitën që të theksoj se kur bëhet fjalë për qëllimet kombëtare, ndërsa perspekti-

va evropiane është qëllim i tillë, është e nevojshme mbështetje nga të gjithë lojtarët kyç, pa dallim nëse janë në Qeveri apo në opozitë", tha Han. Qëllimi i vizitës së tij mes të tjerash ka qenë të marrë bindje dhe garanci nga të gjithë lojtarët kyç se janë të përkushtuar në perspektivat evropiane. Për këtë, siç tha, ka qenë i bindur se Gruevski, në

takimin e djeshëm, kur i është theksuar se VMRO-DPMNE është e përkushtuar në perspektivat evropiane dhe se partia do të luajë rol konstruktiv në atë drejtim. Han përmendi se BE vëren se në vend ekziston përmirësim lidhur me sundimin e të drejtës, për çfarë dëshmi janë vlerësimet e OSBE-ODIHR për zgjedhjet lokale. Në pyetjen nëse partitë politike në takimin në shtëpinë e Zhan Mone në Paris do të bisedojnë për kontestin me Greqinë rreth emrit kushtetues dhe nëse konsideron se Maqedonia duhet të bëjë lëshime, Han tha se politikanët e Maqedonisë janë të obliguar para qytetarëve të gjejnë zgjidhje, të gjejnë kompromis. "Këto çështje për të cilat nuk dua të komentoj, ende është herët, por pozitivisht është që po zbatohen masa për ndërtimin e besimit, ka kontakte mes përfaqësue-

"Nevojitet që të miratohen të gjitha ligjet në fushat e jurisprudencës, zbulimit dhe administratës publike, që është kyçe që të merret rekomandim pozitiv nga BE. Shpresojmë se kjo do të ndodhë diku nga shkurti, me shpresë se negociatat do të fillojnë vitin e ardhshëm...", tha Han

ve relevantë", tha Han dhe edhe njëherë shfaqti kënaqësi nga marrëveshje mes Maqedonisë dhe Bullgarisë, për të cilën tha se pret se Parlamenti do ta ratifikojë deri në fund të vitit.

KRYEMINISTRI ZAEV PRITET NGA KREU SHTETËROR SERB

# INTERESA TË PËRBASHKËTA ME SERBINË

Me interes të posaçëm, siç kumtuan Zaev dhe Vuçiq, është bashkëpunimi në sferën e çështjeve të sigurisë, mirëqenia ekonomike dhe sociale e qytetarëve të të dy vendeve, si dhe nismat rajonale për të cilat edhe nga Maqedonia edhe nga Serbia ka interes jashtëzakonisht të madh



Shkup, 21 nëntor - Miqësia e mirë tradicionale dhe bashkëpunimi mes të dy vendeve, si potencial i jashtëzakonshëm për thellim të këtyre relacioneve, para të cilave paraprijnë mundësi të shkëlqyera për më shumë nisma të reja në më shumë sfera, me respekt të ndërsjellë lidhur me interesat personale strategjike, konstatuan kryeministri e Maqedonisë, Zoran Zaev dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq në takim të djeshëm në Beograd. Në takim morën pjesë zëvendëskryetari i Qeverisë dhe ministri i Punëve të Brendshme Oliver Spasovski, ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës Damjan Mančevski dhe sekretari shtetëror në Ministrinë e Punëve të Jashtme Viktor Dimovski. Të dy bashkëbiseduesit kanë theksuar se të dy shtetet ndajnë shumë interesa të përbashkëta siç janë integrimet evropiane për të cilat është biseduar të vazhdojnë projektet e përbashkëta në këtë plan. Me interes të posaçëm, siç kumtuan Zaev dhe Vuçiq, është bashkëpunimi në sferën e çështjeve të sigurisë, mirëqenia ekonomike dhe sociale e qytetarëve të të dy vendeve, si dhe nismat rajonale për të cilat edhe nga Republika e Maqedonisë edhe nga Republika e Serbisë ka interes jashtëzakonisht të madh. Janë hapur shumë projekte për bashkëpunim gjatë këtij takimi për të cilat do të vijojnë përgatitje konkrete dhe dinamike e cila do të konfirmohet në seancën e përbashkët qeveritare të paralajmëruar e cila do të mbahet së shpejti. Janë konfirmuara idetë

për bashkëpunim në planin e digitalizimit, start-up nismave dhe teknologjitë inovative dhe për pjesëmarrje të përbashkët të sipërmarrësve prej të dy anëve në tregjet e treta. Në takim është dakorduar që Maqedonia dhe Serbia t'i riafirmojnë idetë për bashkëpunim në shënimin e ngjarjeve të rëndësishme, datave dhe vendeve konkret në planin kulturor në nivel të qendrave kulturore-informative në të dy kryeqytetet. Kryeministri Zaev paraprakisht në suaza të vizitës së parë të tij zyrtare në Serbi u takua edhe me kryeministren serbe Ana Bërnabiq.

"Maqedonia e respekton dialogun që Serbia e ka hapur me Kosovën, respektivisht mes Beogradit dhe Prishtinës dhe besoj se në interes të Serbisë do të gjendet zgjidhje. Ne këtë e përkrahim tërësisht dhe shpresojmë se kjo do të jetë së shpejti, pasi kjo është me interes për Serbinë dhe perspektivën evropiane, por po ashtu nga kjo çështje varet edhe perspektiva e tërë rajonit tonë", deklaroi Zaevi

**"Maqedonia e respekton dialogun që Serbia e ka hapur me Kosovën, respektivisht mes Beogradit dhe Prishtinës dhe besoj se në interes të Serbisë do të gjendet zgjidhje. Ne këtë e përkrahim tërësisht dhe shpresojmë se kjo do të jetë së shpejti"**

në konferencën e përbashkët për shtyp me kryeministren serbe, Ana Bërnabiq. Ne, siç potencoi Zaev, jemi popuj të afërt dhe obligimet tona si politikanë është ta ndjekim interesin dhe ta avancojmë bashkëpunimin mes dy popujve tanë. "Ajo që u kontraktua mes dy qeverive dhe në nivel më të lartë presidencial është që për çdo çështje, sado që të jetë e dhimbshme apo pozitive, çdoherë të ngremë telefonin dhe të bisedojmë dhe të arrijmë marrëveshje për atë që duhet, pasi miqtë ashtu bëjnë", tha

kryeministri i Maqedonisë, duke iu përgjigjur pyetjes së gazetarëve. Lidhur me rastin me të punësuarin në ambasadën serbe në Shkup, i cili ishte në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë më 27 prill, gjatë incidenteve, Zaev tha se në atë frymë, në mënyrë shumë miqësore dhe diplomatike është gjetur zgjidhje për atë rast. "Kemi bërë marrëveshje bilaterale, ne kemi tërhequr njeri tonin, Serbia të vetin", tha Zaev. Për kryeministren Bërnabiq kjo vizitë e parë zyrtare e kryeministrit të Maqedonisë në Beograd është, siç tha, sinjal i mirë për të gjitha aktivitetet tona dhe të gjitha çështjet e hapura që të zgjidhet me dialog. "Ky është hap i madh për këtë", tha Bërnabiq. Vizitën në Beograd, kryeministri Zaev e përfundon me takim me përfaqësues të komunitetit maqedonas në Serbi, kur do të dorëzojë donacion të letërsisë adekuate për gjuhën maqedonase, lektura dhe mjete ndihmëse mësimore me qëllim të përfundimit të procesit të studimit të lëndës "Gjuha maqedonase me elemente të kulturës nacionale".

## ZAEVI TREGON SI U ZGJIDH KONFLIKTI DIPLOMATIK MAQEDONI-SERBI

Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, i cili ndodhet për vizitë në Beograd, pasi ka shfaqur dëshirën që dialogu midis Beogradit e Prishtinës të rezultojë me zgjidhje sa më shpejt, ka sqaruar edhe gjetjen e zgjidhjes për konfliktin diplomatik midis Maqedonisë e Serbisë, muaj më parë. Ai tha se zgjidhja u gjet përmes rrugëve miqësore e diplomatike. "Bëmë marrëveshje bilaterale, ne tërhoqëm njeriun

tonë, Serbia tërhoqi njeriun e vet. Kështu bëjnë miqtë", u shpreh Zaev, duke konstatuar se shërbimet informative duhet të jenë të ndërlidhura, të shkëmbejnë informata dhe të ndihmohen reciprokisht. Ai vlerësoi po ashtu se marrëdhëniet midis Serbisë e Maqedonisë janë miqësore dhe në nivel të lartë, ndërsa integrimet evropiane përbëjnë prioritet në politikat e të dy vendeve.

## Asnjë Qeveri të mos vendosë në emër të mediave

Shkup, 21 nëntor - Këshilli për etikë në mediat e Maqedonisë (KEMM), në prag të ndryshimeve të paralajmëruara të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, sot kumtoi se fuqishëm mbetet në qëndrimin se nevojitet të eliminohet çfarëdo ndikimi i shtetit mbi procesin e vetë rregullimit në media. Në kumtesën e KEMM-së thuhet se funksionimi efikas i vetë rregullimit në media përjashton çfarëdo lloji të vendosjes së standardeve gazetareske mediatike në kornizë ligjore dhe vendosje të sanksioneve ndaj mediave për mosrespektimin e tyre. "Kur bëhet fjalë për raportim etik dhe profesional, asnjë qeveri dhe parti politike nuk duhet të vendosin në emër të mediave. Në atë drejtim, KEMM i kundërshtohet Propozim - ndryshimeve të nenit 61 në Projekt ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, që ka të bëjë me parimet dhe standardet në punën e radiodifuzerëve, si dhe të ndryshimeve në nenin 145, me të cilat propozohet shqiptimin e dënimeve nëse standardet profesionale nuk respektohen", thuhet në kumtesë.

Në rrethana në të cilat vetë rregullimi në media në shtet në mënyrë graduale filloi të pranohet dhe gjithnjë e më tepër të përkrahët puna e Këshillit për etikë në media, thuhet në tekst, vendosja e pengesave të ndryshme nga ana e Qeverisë në atë rrugë dhe marginalizimi i punës së Këshillit do të rezultojë me zvogëlimin e përgjegjësisë të vetë mediave dhe përkrahja e praktikës së censurës dhe vetë censurës. Duke i përsëritur angazhimet paradokshe të shprehura të Qeverisë për inkurajim të fuqishëm të sistemit të vetë rregullimit mediatik, KEMM përkujton se vetë rregullimit nuk duhet t'i jepet rëndësi e shkallës së dytë, por të jetë një nga prioritetet në arritjen e ndryshimeve dhe reformave në punën e mediave.

## KRONIKË

Dërgon veturën  
në autolarje,  
punëtori ia vjedh

22-vjeçari me iniciale V.A. nga Tetova, ka denoncuar se të hënën, rreth orës 16.00, i është marrë vetura e tipit "Opel Antara", me targa të Tetovës, pronë e babait të tij, të cilën rreth orës 13.00, e ka lënë në një autolarje në rrugën "167" në Reçicë të Vogël. Kur është kthyer, vetura nuk ka qenë në vendin që e ka lënë më parë, ndërsa të njëjtën e kishte marrë i punësuar në autolarje 25-vjeçari me iniciale SH.Z. për të shkuar në vizitë në spitalin klinik të Tetovës. Tre orë e gjysmë më vonë i dyshuari SH.Z. është gjetur dhe është arrestuar, ku më pas është biseduar me të për zbardhjen e plotë të rastit, dhe më pas do të pasojë padi adekuate.

Arrestohen dy shtetas  
të Shqipërisë

Të hënën, rreth orës 11.00, në Gostivar janë arrestuar dy shtetas të Shqipërisë, 28-vjeçari me iniciale E.Ç dhe 56-vjeçari me iniciale G.Ç., të cilët pa lajmëruar kanë qëndruar në rajon. Pas arrestimit dhe mbajtjes së shkurtër shtetasit shqiptarë janë dorëzuar në sektorin për kriminalitet ndërkufitarë të huaj dhe migracion për procedurë të mëtejshme, pas çka janë deportuar në shtetin e tyre amë.

Tragjedi në Dobrosht,  
vdes në aksident  
vajza 8-vjeçare

Të hënën, rreth orës 23.00, në stacionin policor në Tearcë. B.B. 46-vjeçar nga fshati Dobrosht, ka denoncuar se në të njëjtën ditë rreth orës 15.00, së bashku me vajzën e tij 8 vjeçe, me një veturë të tipit "Mahindra" ka qenë në atarin e fshatit Dobrosht për të bartur dru. Në një moment përderisa vajza e tij ka qenë në veturë, ndërsa babai i saj që rastin e ka paraqitur në polici, ka qenë duke grumbulluar dru, vetura, për arsye të panjohura deri më tani, është lëshuar dhe ka marrë tatëpjetën. Kur këtë e ka vërejtur vajza e tij ka, kërcyer nga vetura, pas çka ka goditur në një gur dhe për pasojë ka marrë lëndime në pjesën e kokës. Pas kësaj, babai me inicialet B.B. ka marrë në krahë vajzën e tij dhe në këmbë është nisur drejt fshatit Dobrosht, me qëllim që ta dërgojë në spital dhe përderisa ka lëvizur në drejtim të fshatit, e ka takuar A.A. nga i njëjti fshat i cili me anë të një veture "Xhip" e ka dërguar deri në fshatin Dobrosht. Kur kanë mbërritur në fshat, kanë vërejtur se nga lëndimet e marra vajza ka vdekur dhe kanë vendosur që të mos e dërgojnë në spital, por e kanë dërguar në shtëpi. Për shkak se denoncuesi, në këtë rast babai i vajzës, rastin nuk e kanë paraqitur menjëherë në polici. Pas paraqitjes së rastit në polici, trupi i vajzës tanimë të ndjerë, nga ana e familjes, me asistencë të pjesëtarëve të policisë, është dorëzuar në mjekësinë ligjore për obduksion, njofton Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë. (U.H)

## PRONARI I KOMPANISË "FIÇO SERVIS" SI DËSHMITAR NË RASTIN "TRUST"

FATURAT I NJOH,  
POR JO EDHE  
NËNSHKRIMIN

Dukshëm i shqetësuar, për shkak se siç tha dëshmitari Feim Imeri, kjo ishte hera e parë e tij të paraqiten në një procedurë gjyqësore, ai reagoi ashpër në disa pyetje të parashtruara nga prokurori special, Artan Ajro

Koha

Omer XHAFERI

Shkup, 21 nëntor - Dinamika e shpejtë e procesit gjyqësor për rastin "Trust", e imponuar nga gjykatësja Lidija Trajkovska, të martën ka vazhduar me prezantimin e dëshmitarëve të propozuar nga Prokuroria Speciale Publike. Dilemat e shumta dhe kundërshtimet e ndryshme, të iniciuar nga pala mbrojtëse e të akuzuarve Sead Koçan, Vasilije Aviroviq dhe Safet Vatiq, me qëllim prolongimin e seancën, kësaj radhe nuk u morën parasysh nga Trupi gjyqësor. Me qëllimin e vërtetimit e tezës se dokumentacioni për fitimin e tenderit milionësh nga konzorciumi i kompanive "Transmet-Sileks Nemetali-Vato", është i falsifikuar, PSP-ja, si dëshmitar, të martën e propozoi pronarin e kompanisë "Fiço Servis". Gjatë prezantimit të tij, dëshmitari Feim Imeri, tha se biznesin me shitblerjen e makinave për ndërtime të ushtron që nga viti 1991 dhe prej asaj kohe e deri më sot, në vazhdimësi ka bashkëpunuar me Kompaninë "Transmet", pronë e familjes Koçan. Dukshëm i shqetësuar, për shkak se, siç tha dëshmitari Feim Imeri, kjo ishte hera e parë e tij të paraqiten në një procedurë gjyqësore, ai reagoi ashpër në disa pyetje të parashtruara nga prokurori special, Artan Ajro. Prezantimi i një marrëveshjeje të kontraktuar mes firmës "Fiço Servis" dhe "Transmet", dhe tre faturave për shitblerje, si dëshmi nga PSP-in, ishin provat përmes të cilëve prokurori special tentoi të sqarojë dilemat se në këtë rast janë falsifikuar dokumente gjatë tenderimit.

"Kjo marrëveshje dhe faturat janë siguruar nga kontrolli ynë i realizuar në kompaninë 'ELEM'. Të njëjtat janë kopjuar, për shkak se këto fatura origjinale ne nuk i kemi gjetur në kompaninë e dëshmitarit. Këto dokumente janë të falsifikuara dhe për këtë arsye ju kemi ftuar", tha prokurori special, Artan Ajro, duke i shpjeguar dëshmitarit se për çfarë arsye është thirrur të prononcohet.

Këtij qëndrimi të prokurorit special, i ka parapri toni shqetësues i dëshmitari,

Feim Imeri, i cili ju drejtuar gjykatësës, se ai është dashur të ftohet bashkërisht me kontabilistin dhe sekretarin e firmës, për shkak se jo të gjitha të dhënat i mban mend.

"Gjykatëse, në këtë mënyrë nuk mund të përgjigjem unë. Për këtë çështje kam angazhuar kontabilist. Në kompaninë tim brenda ditës qarkullojnë shumë fatura, nuk mbaj mend se çka ka ndodhur në vitin 2009. Këto fatura që më prezantohen janë të mijat, edhe memorandumit dhe marrëveshja, po ashtu. Mirëpo, për nënshkrimin nuk mund të them se është i imi. Ekzistojnë tre nënshkrime të ndryshme", tha dëshmitari, Feim Imeri. Ai, mes tjerash, shtoi se nuk ka njohuri se vallë këto fatura janë realizuar (paguar), respektivisht gjatë gjithë kohës nuk janë përmendur shifra të të hollave për lartësinë e faturave.

Megjithatë, në një pjesë të dëshmisë së tij, dëshmitari Imeri, tha se i akuzuari Sead Koçan, në një periudhë të caktuar nuk ka arritur t'ia paguajë një eskavator, për të cilën paraprakisht kishin lidhur marrëveshje. Mos sigurimi i mjeteve në kohë, sipas dëshmitarit, ka qenë arsye se pse Koçan ka hequr dorë nga blerja e një eskavatori (makine për ndërtime). Përplasja mes dëshmitarit dhe prokurorit, ishte shkaku që e detyroi Trupin gjyqësor, t'ia tërheq vërejtjen dëshmitarit Feim

Imeri, se nëse nuk i përmbahet pyetjeve të prokurorit, ai mund të dënohet.

Ndërkaq, dëshmitari i dytë e PSP-së për rastin "Trust", të martën nuk është paraqitur në seancën gjyqësore kundër të akuzuarve, Sead Koçan, Vasilije Aviroviq dhe Safet Vatiq.

Përfaqësuesit e PSP-së, theksuan vazhdimisht se e kanë kërkuar në celular, mirëpo i njëjti nuk është përgjigjur. Për këtë shkak, gjykatësja e rastit solli vendim që në seancën e ardhshme, ky dëshmitar të sillet në gjykatë nën shoqërimin e policisë.

Ndryshe, pala mbrojtëse deri sa dëshmitari nuk filloi me dhënien e deklaratës para Trupit gjyqësor, vazhdimisht reagonte. Megjithatë, pas përfundimit të pyetjeve nga përfaqësuesit e PSP-së, ata hoqën dorë nga parashtrimi i pyetjeve të kryqëzuara, veprim ky i cili lejohet nga Ligji i ri për procedurë penale. Lidhur me këtë situatë, gjykatësja Lidija Petrovska Zimbovska, u tha avokatëve se nuk është në rregull që ata të mos dinë se si duhet të parashtruhet pyetje e kryqëzuara, përderisa dispozitat e ligjit në fjalë praktikohen një kohë të gjatë. Trupi gjyqësor, duke e pasur parasysh peshën e këtij rasti, ka vendosur që brenda këtij muaji të mbahen edhe dy seanca për rastin "Trust", ndërkohë për muaji dhjetorë janë caktuar edhe katër seanca tjera.

## PËRSËRI U ANULUA RASTI "TREQIND"

Ish ndihmës ministri i Punëve të Brendshme, Gjoko Popovski, i akuzuar kryesor në rastin "Treqind", të martën përsëri nuk u paraqit në Gjykatë. Pala mbrojtëse e të akuzuarit, gjatë sqarimit të arsyeve të mungesës, deri te gjykatësja Lidija Petrovska parashtrori një vërtetim mjekësor, i cili e konstaton qëndrimin e avokatëve se klienti i tyre është i palëvizshëm. Lidhur me këtë çështje, reagoi prokurorja speciale, Fatime Fetaj, e cila tha se nuk mund të prit me vite që ky gjykim të fillojë dhe se seancat gjyqësore nuk mund të varen sipas dëshirave të të akuzuarve. "Propozoj

person ekspert me njohuri përkatëse të konfirmojë se i akuzuari nuk mund të vijë në seancë. Popovskit ndoshta i duhen dy vite që të shërohet, ne a q do të presim?" tha Fetaj.

Gjykatësja Lidija Petrovska, me këtë rast vendosi se mungesa e të akuzuarit është justifikuar dhe gjykimi shtyhet për 27 nëntor. Ndryshe, në lëndën "Treqind" ish ndihmës ministri i Punëve të Brendshme, Gjoko Popovski, akuzohet për keqpërdorim të detyrës zyrtare lidhur me furnizimin publik të 300 automjeteve. Ai, nga ana e PSP-së, dyshohet se e ka dëmtuar arkën e shtetit për 453.570 euro.

MASH HEQ DORË EDHE NGA NJË PROJEKT NË ARSIM



Buxheti	2017	2018
Total	1.684.257.000	1.232.080.000
Buxheti bazë	1.432.460.000	956.806.000
Përkthim dhe botim i literaturës profesionale	76.250.000	60.124.000
Program për vendosjen e laboratorëve	20.000.000	nuk ka
Përkthimi i librave me renome	100.000.000	50.000.000
Ndihmë për transformimin dhe ndërtimin institucional	193.654.000	190.950.000
Zhvillim i resurseve njerëzore	2.327.000	150.000.000
Ndërtim i shkollave fillore	200.000.000	162.600.000
Rikonstruim i shkollave fillore	50.000.000	50.000.000
Ndërtim i sallave sportive të shkollave fillore	384.497.000	64.846.000
Ndërtim i shkollave të mesme	25.000.000	40.000.000
Rikonstruim i shkollave të mesme	30.000.000	30.000.000
Ndërtim i sallave sportive të shkollave të mesme	20.000.000	8.136.000
Rikonstruim i konvikteve	5.000.000	30.000.000
Ndërtim dhe rikonstruim i konvikteve studentore	325.000.000	270.000.000
Borxhe	226.300.000	240.312.000
Donacione	25.497.000	34.962.000

# SHUHET IDEJA PËR AKADEMINË E MËSUESVE

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 21 nëntor - Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), sipas të gjitha gjasave ka hequr dorë nga themelimi i Akademisë së Mësuesve, e cila u lansua vite përpara si mekanizëm, me të cilin MASH synonte të vjen deri të rritja e cilësisë së mësimdhënies nëpër shkollat fillore dhe të mesme. Përmes kësaj Akademie, Qeveria e përparshme, e kryesuar nga VMRO-ja, pretendonte se do të sigurohet mekanizmi për përgatitjen e mësimdhënësve kualitativ, mirëpo as në kohën e asaj qeverie nuk u ndërmorën hapa konkret për jetësimin e idesë për themelimin e Akademisë së Mësuesve. Madje, u ndryshuan dy herë afatet ligjore për fillimin me punë të kësaj Akademie, e cila do të liçensonte të gjithë kuadrot me përgatitje profesionale para se të fillonin punë si mësimdhënës.

Ishte planifikuar që në kuadër të saj të bëhet deri edhe rikualifikimi i të gjithë atyre kuadrove që ta-

Me politikat e reja në arsim, siç duket po hiqet definitivisht dorë nga ideja për themelimin e Akademisë së Mësuesve, apo nga pretendimi për ndërtimin e mekanizmit për rritjen e cilësisë në nxjerrjen e kuadrove mësimdhënës

shme janë të angazhuar si mësimdhënës, me qëllim të mbajtjes edhe më tej të vendit të punës. Në shpërbllim të kësaj, mësuesit, arsimtarët dhe profesorët që do të bënin rikualifikimin përkatës, do kishin një rritje page prej 50 euro në muaj. Por, pavarësisht planifikimeve të Qeverisë së kaluar, Akademia e Mësuesve mbeti vetëm një projekt në letër.

Sakaq, me politikat e reja në arsim po shuhet definitivisht shpresat për ndërtimin e atij mekanizmi, respektivisht për themelimin e Akademisë, pasi vlera e saj në buxhetin e vitit 2018 është shumëzuar me zero. Konkretisht, ajo nuk është vendosur as si zë i buxhetit

të planifikuar të arsimit dhe shkencës për vitin e ardhshëm, që do të thotë se për të nuk është parashikuar të ndahet asnjë denarë.

Ndërkaq, me buxhetin e para një viti ishin caktuar rreth 832.536 euro (51.201.000 denarë). Këtë vit, buxheti i MASH-it nuk parashihet mjetet as për Programin e vendosjen e laboratorëve në institucionet e arsimit të lartë, gjë për të cilën, në buxhetin e para një viti, ishin të planifikuara rreth 325.200 euro (20.000.000 denarë). Marrë në përgjithësi, nëse krahasohen buxhetet e dy viteve të fundit, ky i 2018-ës rezulton dukshëm më i shtrënguar se buxheti paraprak. Nëse 2017 për arsimin dhe shkencës ishin

planifikuar mbi 27.386.000 euro (1.684.257.000 denarë), me atë që 23.292.000 euro (1.432.460.000 denarë) nga buxheti bazë, për vitin tjetër (2018) buxheti në total i arsimit dhe shkencës është rreth 20.038.000 euro (1.232.080.000 denarë), me atë që rreth 15.558.000 euro (956.806.000) nga buxheti bazë. Diferencat në buxhet, sikurse dihet planifikohen të realizohen përmes të hyrave vetanake që realizojnë institucionet, donacioneve dhe huamarrjes.

Në këtë pikë buxheti i 2018-ës është më i fryrë se ai i një viti më parë, pasi për huat planifikohen 240.312.000 denarë (për dalim prej 226.300.000 denarëve të një viti më parë), kurse nga donacionet 34.962.000 denarë (për dallim prej 25.497.000 denarëve të një viti më parë). Pavarësisht shkurtesave të përgjithshme në totalin e buxhetit të MASH-it, nga viti 2017 në vitin 2018 është shënuar rritje e konsiderueshme në zërimin për arsim të lartë. Nga përafërsisht 46.135.800

euro (2.837.354.000 denarë), buxheti për këtë qëllim ka shkuar në rreth 49.937.100 euro (3.071.133.000 denarë). Çdo herë, sipas planifikimit nga buxheti bazë, rënie më të madhe ka buxheti i Universitetit "Kirili dhe Metodi" në Shkup, edhe atë nga 46.135.800 euro (2.837.354.000 denarë) në 21.986.569 euro (1.352.174.000 denarë). Buxheti ka pësuar rënie edhe për Universitetin e Tetovës, nga 6.090.178 euro (374.546.000 denarë) në 5.371.479 euro (330.346.000 denarë), si dhe për Universitete e Shtipit dhe Ohrit. Shtim buxheti ka për Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup, nga 1.331.219 euro (81.870.000 denarë) në 4.689.235 euro (288.388.000 denarë), si dhe për Universitetin e Manastirit nga 4.439.528 euro (267.496.000 denarë) në 4.349.528 euro (296.421.000 denarë). Në buxhetin e planifikuar për UNT-në janë paraparë edhe mjetet për ndërtimin e kampusit universitar, për dallim prej mjeteve për ndërtimin e fakultetit të Informatikës dhe Komunikacionit si dhe të Fakultetit të Kulturës Fizike të UKM-së, për të cilët është planifikuar buxhet në zërim të veçantë nga ai për UKM-në. Pra, për ndërtimin e objektit të atyre dy fakulteteve, janë ndarë mbi 3.252.032 euro (200.000.000 denarë).

## Deri në 2050 dyfishohet numri i pleqve

Shkup, 21 nëntor - Sipas parashikimeve të Kombeve të Bashkuara, deri në vitin 2050 në Maqedoni të moshuar do të jenë 33 për qind e popullatës. Në vitin 2008, sipas të dhënave statistikore, persona të moshuar kanë qenë 16.6 për qind e popullatës, ndërsa në regjistrimin në vitin 2002 rreth 15 për qind. "Maqedonia përballat me numër të madh të popullatës së vjetër. Sipas vlerësimeve të KB-së jetëgjatësia e qytetarëve të Maqedonisë deri në vitin 2050 vazhdimisht do të rritet,

kështu që atëherë 33 për qind e popullatës do të jetë mbi moshën 60 vjeçare", tha sekretari i përgjithshëm i Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë, Sait Saiti në konferencën e djeshme për shtyp me rastin e Javës për kujdes për personat e moshuar "Të gjithë jemi fëmijët e tyre". Qëllimi i shënimit të kësaj Jave, sipas tij është që të ngrihet vetëdija publike për nevojën nga intervenimi i personave të moshuar, por edhe për sigurim të kujdesit dhe ndihmës për ta, duke e pasur parasysh rritjen e

vazhdueshme të përqindjes së popullatës së moshuar. "Nga këto të dhëna rrjedh se nevojat për personat e moshuar për mbrojtje sociale dhe shëndetësore vazhdimisht rriten dhe si rezultat i kësaj imponohet nevoja nga përfaqësimi dhe zhvillimi i formave për mbrojtje jashtë institucionale, që do të mundësojnë shërbime të afërta deri të shfrytëzuesit për të cilët dedikohen", tha Saiti. Zëvendësministri i Punës dhe Politikës Sociale, Elmi Aziri, konsideron se pasojat nga vjetërsimi si



proces mund të ndjehen në të gjitha sferat e jetës shoqërore dhe se për këtë të gjitha vendet, duke e përfshirë edhe Maqedoninë, ndërmarrin

masa dhe politika për tejkalimin e pasojave, por edhe mundësim të kujdesit adekuat dhe mbrojtje të personave të moshuar.

Madje 24 e qytetarëve gjatë muajve të fundit kanë përdorur rregullisht ilaçe qetësuese, ndërsa 40 për qind të paktën një herë gjatë muajit të fundit kanë konsumuar të njëjtat ilaçe

Shkup, 21 nëntor - Gati gjysma e qytetarëve, ose 46 për qind e moshës nga 15 deri në 64-vjeç janë duhanpirës aktiv, derisa 65 për qind e qytetarëve në nivel shteti konsumojnë alkool. Kështu tregojnë rezultatet e hulumtimit të quajtur "Përdorimi i substancave psikoaktive mes popullatës në Maqedoni" të realizuar nga Instituti i Shëndetit Publik, sipas të cilit, madje 24 e qytetarëve gjatë muajve të fundit kanë përdorur rregullisht ilaçe qetësuese, ndërsa 40 për qind të paktën një herë gjatë muajit të fundit kanë konsumuar të njëjtat ilaçe. Gjatë gjithë jetës së tyre, 9 për qind e popullatës kanë marrë çfarëdo lloj droge legale, ndërsa më shpeshti mariuhanë edhe atë 8.2 për qind. "Në moshë prej 15 deri

REZULTATE SHQETËSUESE TË ISHP-së

# TË VARUR NGA DIAZEPAMI



34 vjet aktivisht pinë duhan 40.2 për qind e qytetarëve, 76 për qind kanë konsumuar alkool, 14 për qind gjatë muajit të fundit kanë konsumuar qetësues, ndërsa 60 për qind të paktën njëherë kanë konsumuar qetësuese, derisa 15 për qind kanë konsumuar kanabis", ka thënë dr.Silvana Onçeva nga Instituti për Shëndet Publik. Në hulumtim, ka informuar ajo,

janë përfshirë 5005 qytetarë të Shkupit.

"Burrat përdorin më shumë substanca narkotike për dallim nga gratë që përdorin më shumë qetësuese", tha ajo. Onçeva potencoi se drogën më shpesh e konsumojnë persona të moshës prej 17 deri 27 vjet, në përfundim të kokainës të cilën e konsumojnë persona më të moshuar se 30 vjeç.

Në ndërkohë, drejtori i Institutit për Shëndet Publik të Maqedonisë, Shaban Memeti, tha se pjesë e drogave ilegale janë të distribuara edhe në Maqedoni. "Gjatë periudhës së kaluar, në Republikën e Maqedonisë janë realizuar disa hulumtime në lidhje me përdorimin e drogave, duhanit dhe alkoolit nga ana e nxënësve, fëmijëve prej 11-16 vjeçar. Përdorimi i dro-



SHABAN MEMETI

**Përdorimi i drogave ilegale është rreth 2 për qind, por shqetësues është fakti se ka një tendencë të rritjes së këtij numri e që ka të bëjë me moshën, kështu në moshën 15-16 vjeç tashmë rreth 5 për qind të fëmijëve kanë rrëfyer se deri në atë çast - ata tashmë kanë provuar të paktën 1-2 herë mariuhanë**

gave ilegale është rreth 2 për qind, por shqetësues është fakti se ka një tendencë të rritjes së këtij numri e që ka të bëjë me moshën, kështu në moshën 15-16 vjeç tashmë rreth 5 për qind të fëmijëve kanë rrëfyer se deri në atë çast - ata tashmë kanë provuar të paktën 1-2 herë mariuhanë", tha Shabani. (A.Xh)

Publicitet

## NDËRMARRJA PUBLIKE PËR VEPRIMTARI ENERGETIKE "STRUMICA – GAS" STRUMICË

Në bazë të nenit 37-e dhe nenit 37-i të Ligjit për ndërmarrje publike (Gazeta Zyrtare e RM nr. 38/96, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15 dhe 39/16) nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 129/15 dhe 27/16), nenit 23 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik dhe Rregulloren dhe elementet e domosdoshme të shpalljes publike për plotësimin e vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe paraqitjes për punësim, si dhe formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejtshme gjatë punësimit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 34/15) Drejtori i NPVE "Strumica – Gas" Strumicë, publikon

### SHPALLJE PUBLIKE 3/2017

Për punësim për kohë të pacaktuar jo të plotë të punës për 1 (një) ofrues të shërbimit publik

1. KDR 0305 B04005 Teknik të operativës – Shërbimi administrativ profesional, Reparti për distributiv

#### Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase
- Të jetë i/e moshës madhore
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës

Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

- me së paku nivel të kualifikimeve IV 240 kredi sipas ECVET ose MKSOO ose arsim të mesëm katërvjeçar
- me ose pa përvojë pune.

#### Orari i punës:

Ditë e punës e hënë - e premte  
Orët javore të punës 40  
Orari ditor i punës 08:00 deri më 16:00  
Rroga neto 15.452,00 den.

VËREJTJE: Punësimet e planifikuara në pajtim me planin vjetor të institucionit për vitin 2017 janë: Maqedonas(e) 1

Afati për paraqitje është 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Kandidatët janë të obliguar që fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, saktë dhe me të dhëna të sakta, fletëparaqitjen mund ta marrin nga arkivi i ndërmarrjes.

Fletëparaqitjet e plotësuar së bashku me shtojcat, kandidatët mund ti dorëzojnë personalisht në arkivin e NPVE "Strumica – Gas" Strumicë ose përmes postës në adresën: bul. Marshall Tito pn (në ndërtesën mbi Bankën Komerciale kati i 3-të) Strumicë. Procedura për përzgjedhje të kandidatëve të paraqitur përbëhet nga kontrollimi i të dhënave të futura në fletëparaqitjen për punësim me kushtet e përcaktuara në shpalljen publike, do të informohen për kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës.

Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrojnë:

- biografi të shkurtë
- certifikatë të shtetësisë
- dëshmi për arsimin e mbaruar
- fotokopje të dokumentit për identifikim
- dëshmi për aftësinë e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës
- dëshmi se nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Fletëparaqitja e dorëzuar pas afatit, jo e plotë dhe e parregulluar, nuk do të jetë lëndë e shqyrtimi nga ana e Komisionit për realizim të procedurës për punësim.

NPVE "Strumica – Gas" Strumicë  
U. D Drejtor , inxhi.dipl.mak Bllagoj Millanoviq

## KOMUNA E ÇAIRIT ОПШТИНА ЧАИР

Në bazë të nenit 21 nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik ( Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 199/2014,44/2015,193/15,31/16, 163/16,90/2017), Kryetari i Komunës së Çairit, e solli këtë:

### L A J M È R I M

Lajmërohen qytetarët dhe personat juridik të territorit të Komunës së Çairit se shpallet

#### Thirrje publike për dorëzimin e iniciativës për përpilim të Planeve urbanistike

Thirrja publike shpallet në pajtueshmëri me nenin 21 nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 199/2014,44/2015,193/15,31/16, 163/16, 90/2017.), në kuartalin e tretë të vitit 2017.

- **Thirrja publike do të zgjasë prej 23.11.2017 deri më 22.12.2017 - 30 ditë**, duke llogaritur nga dita e shpalljes.

- **Thirrjes publike** do të shpallet në Fletën zyrtare të Komunës, në internet faqen e Komunës së Çairit [www.cair.gov.mk](http://www.cair.gov.mk), në tabelën e shpalljeve në komunë, në sistemin informativ e-urbanizëm, në gazetën ditore në gjuhën maqedonase "NOVA MAKEDONIJA" dhe gazetën ditore në gjuhën shqipe "KOHA".

- Në periudhë e zgjatjes së Thirrjes publike, të gjithë personat e interesuar fizik dhe juridik të dorëzojnë iniciativën për përpilimin e Planeve urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 alineja 2, 3 dhe 4 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 199/2014,44/2015,193/15,31/16, 163/16, 90/2017).

- Personat e interesuar juridik dhe fizik iniciativat ti dorëzojnë në formë të shkruar nëpërmjet arkivit të Komunës së Çairit ose në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm në afatin e caktuar.

- Lëndë e iniciativës mund të jetë miratimi i Planit të ri urbanistik ose ndryshim plotësimi i planit ekzistues urbanistik

- Për iniciativat e pranuar parashtuesit do të informohen në formë të shkruar ose në formë elektronike, nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm në afat prej 15 dite nga skadimi i afatit për dorëzimin e iniciativave.

- Iniciativat e pranuar nga Thirrja publike do të shënohen në Programin për përpilim të Planeve urbanistike të territorit të Komunës së Çairit për vitin 2018.

- Mjetet për përpilimin e dokumentacionit të nevojshëm për iniciativat e pranuar duhet ti sigurojnë parashtuesit e iniciativave – persona juridik ose fizik.

Kryetar i Komunës së Çairit  
Prof.Dr. Visar Ganiu



KËRKOHEM SALLË SPORTIVE PËR SHKOLLËN MË TË VJETËR


# NXËNËSIT E “LIRISË” ME KUSHTE MINIMALE

Salla aktuale, krahas që nga nxënësit përdoret për orën edukative, po ashtu aty mbahen edhe shumë manifestime dhe evenimente të tjera shkollore

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 21 nëntor - Nxënësit e Shkollës fillore “Liria” në Tetovë, orën e edukatës fizike e zhvillojnë në një sallë të vjetër që ekziston që kur është ndërtuar shkolla, para 70 viteve. Në kushte mjaft të vështira, të papërshtatshme dhe minimale s’mund të zhvillohet një orë e suksesshme e edukatës fizike. Salla ende është me parket që është vendosur që në kohën e komunizmit, kurse salla është e vogël për të kryer më shumë aktivitete nga ana e nxënësve.

“Salla ku momentalisht zhvillohet ora e edukatës fizike, ka kushte minimale. E njëjta daton që nga koha e kur është ndërtuar shkolla, pra para pothuaj 70 viteve. Prej atëherë të gjithë gjeneratat që kanë mësuar në këtë shkollë, kanë ndjekur mësimin në këtë sallë sportive me kushte aspak të mira. Edhe inventari është vjetruar, kurse gjatë dimrit këtu mbahet ora e mësimin nga fëmijët që ndjekin mësimin



nga klasa e parë e deri në klasën e nëntë”, deklaroi Shpresa Iseini, drejtore e Shkollës fillore “Liria” në Tetovë. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka vendosur që vitin e ardhshëm të ndërtojë sallë edhe në këtë shkollë, gjegjësisht në oborrin e kësaj shkolle që nxënësit të kenë kushte më të mira për zhvillimin e orës së edukatës fizike.

“Kemi një shpresë dhe një paralajmërim se Ministria e Arsimit dhe Shkencës do të ndërtojë sallë të re moderne edhe në shkollën tonë. Ata kanë kërkuar informacion për hapësirë dhe, sipas informacioneve, është pranuar nga ana e Ministrisë së Arsimit që, krahas shkollave tjera fillore në Tetovë, të ndërtohet sal-

lë edhe në Shkollën fillore “Liria”, tha drejtoresha Iseini. Sipas saj, me këtë, nxënësit do të kishin kushte më të mira që të zhvillojnë aftësi edhe në sportet tjera dhe jo vetëm në futboll dhe basketboll. Salla sportive jep më shumë mundësi që ora të jetë më e plotësuar me më shumë aktivitete. Salla aktuale, krahas që përdoret për orën edukative nga nxënësit, po ashtu aty mbahen edhe shumë manifestime dhe evenimente të tjera shkollore që është edhe një ngarkesë më shumë, sepse salla ka pak pajisje. Po ashtu sipas paralajmërimeve pritet që nëse ndërtohet salla, kjo aktualja të shndërrohet në më shumë mësonjëtoje, sepse dihet që në këtë

shkollë ka numër të madh të nxënësve dhe është evidente mungesa e mësonjëtojeve. Përndryshe, sipas informacioneve, në Tetovë vitin e ardhshëm planifikohen të ndërtohen 5 salla sportive në shkollat fillore, edhe atë në “Andreja Savevski Kikish”, “Kirili dhe Metodi”, “Liria”, “Naim Frashëri” dhe “Migjeni”.

Ndryshe në Shkollën fillore “Liria” në Tetovë mësojnë 1150 nxënës. Mësimi në këtë shkollë realizohet në tre gjuhë, shqip, maqedonisht dhe turqisht. Edhe pse Shkolla fillore “Liria” në Tetovë është ndër më të vjetrat në qytet, megjithatë objekti i kësaj shkolle asnjëherë nuk është rindërtuar apo rikonstruuar në mënyrë të mirëfilltë.

## Automjete me defekte në rrugët e Pollogut

Tetovë, 21 nëntor - Në rajonin më të gjerë të Pollogut të, hënën në mëngjes është realizuar një aksion kontrolli ku është kontrolluar gjendja teknike e automjeteve, të cilat kryejnë transport publik, para së gjithash të autobusëve dhe furgonëve. Në aksionin e Tetovës gjithsej janë përfshirë 60 automjete, nga të cilat 44 janë udhëzuar që të kryejnë kontroll të jashtëzakonshëm teknik. Nga këto 44, te 16 prej tyre janë konstatuar defekte të pajisjeve të drejtimit. Për sanksionimin e këtyre dhe kundërvajtjeve të tjera janë përgatitur 22 fletëpagesa për kundërvajtje, përdërisa 4 autobusë menjëherë janë larguar nga komunikacioni, ndërsa 4 automjeteve të tjera nuk janë paraqitur aspak për kontroll teknik.

Në Gostivar janë zbuluar 7 automjete me frena të dëmtuar, nga gjithsej 42 automjetet e kontrolluar në kontrollin e Gostivarit. 28 janë udhëzuar për të kryer kontroll të jashtëzakonshëm teknik. Defektet e tyre si dhe kundërvajtjet e tjera si, drejtim i automjetit pa leje për vozitje, regjistrim i skaduar i automjetit, mbingarkesë dhe të ngjashme, të zbuluara në këtë aksion kontrolli, janë rrumbullakuar me 17 fletëpagesa për gjobë. Qëllimi i këtij aksioni kontrolli është zbulimi dhe largimi në kohë i automjeteve, të cilët nuk janë në gjendje të rregullt teknike, veçanërisht të atyre që kryejnë transport publik të nxënësve në fshatrat përreth Tetovës dhe Gostivarit. (u.h.)

## KONSTITUOHET KËSHILLI KOMUNAL I KOMUNËS SË ZHELINËS

### KRYESUES U ZGJODH LIRIDON USEINI

Tetovë, 21 nëntor - Këshilli Komunal i Komunës së Zhelinës të martën e mbajti seancën e parë konstituiv. Pas formimit të komisioneve të nevojshme, me shumicë votash, për kryesues Këshilli u zgjodh Liridon Useini, njëherësh edhe bartës i listës së këshilltarëve të Lëvizjes BESA.

Para të pranishmëve, fjalë përshëndetëse mbajti edhe kryetari i Komunës së Zhelinës, i cili Këshillit i uroi punë të mbarë dhe të suksesshme. Kryetari para të pranishmëve gjithashtu uroi që ky Këshill të jetë i hapur për qytetarët dhe në shërbim të tyre, të jetë profesional dhe i paanshëm,

të angazhohet për transparencë, llogaridhënie dhe të jetë korrektes i punës së kryetarit dhe administratës komunale. Këshilli Komunal i Komunës së Zhelinës përbëhet nga gjithsej 19 këshilltarë, 9 të Lëvizjes BESA, 8 të Bashkimit Demokratik për Integritet, një i Aleancës për



Shqiptarët dhe një i Partisë Demokratike Shqiptare.

## Presidenti Meta në tribunën shkencore të ITSHKSH-së

Manastir, 21 nëntor - Me prezencën e kryetarit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, zëvendëskryeministrit Hazbi Lika, kryetares së Komunës së Manastirit, Natasha Petrovska, ambasadorëve, drejtuesve të instituteve albanologjike të Shkupit, Tiranës e Manastirit, dhe studiuesve të shumtë, të martën në Manastir u hap tribuna shkencore kushtuar 109 vjetorit të Kongresit të Alfabetit të Shqipes dhe 10-vjetorit të themelimit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup. Kryetari Meta, zëvendëskryeministri Lika dhe kryetarja e Manastirit Petrovska, në hapjen solemne të tribunës,



theksuan rëndësinë e kësaj date të madhe historike për popullin sh-

qiptar, duke potencuar edhe nevojën më të madhe të angazhimit

institucional për zhvillimin e shkencës dhe kulturës shqiptare.

Më tej, fjalë përshëndetëse patën drejtori i ITSKSH-së, dr.Skender Asani, drejtori i Akademisë së Studimeve Albanologjike në Tiranë, akademik Marenglen Verli, drejtori i Institutit të Historisë së Prishtinës, dr. Sabit Syla dhe drejtori i Institutit Albanologjik të Prishtinës, dr. Hysen Matoshi.

Më pas, me kumtesat e tyre u paraqitën studiuesit: Valter Memisha: “Kongresi i Manastirit - ngjarje përcaktuese në rrugëtimin një komb një gjuhe”; Sabile Keçmezi - Basha & Tefik Basha: “Binomi Motrat Qiriazit - misioni atdhetar dhe arsimor i tyre”; Sali Kadria:

“Kongresi i Manastirit - Fillimi i mevetesise kombetare te shqiptareve”; Avzi Mustafa: “Arif Hiqmeti, armik i përbeuar ndaj shkronjave shqipe”; Nebi Dervishi: “Shtypshkronja e parë e Kongresit të Manastirit”; Teuta Toska: “Motrat Qiriazit dhe roli i tyre në zgjimin e vetëdijes kombëtare”; Memli Krasniqi: “Raporti i Gjergj Qiriazit mbi Vilajetin e Manastirit”. Drejtori i ITSKSH-së, dr.Skender Asani, presidentit Meta i dhuroi një pako me libra nga botimet e fundit të Institutit. Aktivitetet për shënimin e 109-vjetorit të Ditës së Alfabetit, organizohen nën patronazhin e zëvendëskryeministrit të Qeverisë së Maqedonisë, Hazbi Lika.

# Dy kongreset që bashkuan shqiptarët

Nga  
dr. Rami MEMUSHAJ



Kalendarin e festave të Nëntorit, këtij muaji të bekuar për shqiptarët, e pasurojnë edhe dy data shumë të rëndësishme që lidhen me dy kongrese gjuhësore: Kongresi i Manastirit dhe Kongresi i Drejtshkrimimit. Këta dy kongrese janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, sepse patën si kryetëmë gjuhën dhe sepse kongresi i dytë është vijim i të parit, që i shtriu udhën. Dhe të dy përbëjnë ngjarje të shënuara për kombin tonë, pa të cilat nuk do të ishte ruajtur njësi jonë kombëtare. Sepse, në qoftë se kombe të tjera janë ngjizur mbi bazën e njësisë shtetërore, fetare e gjuhësore, ne shqiptarët tallazet e mijëvjeçarëve nuk na lanë të kishim shtetin tonë historik, siç e kanë pasur francezët, anglezët etj.; kurse skizmat fetare dhe pushtimet na kanë prishur njësinë e dikurshme fetare, duke na ndarë në tri besime. Pra, për shqiptarët e vetmja shenjë e përbashkësisë është gjuha. Prandaj intelektualët e Rilindjes e vunë theksin pikërisht te gjuha shqipe, që e vlerësuan si mjet dhe shenjë të njësisë kombëtare. Që në agimet e kësaj lëvizjeje, Naum Veqilharxhi shkruante se kombet e mbetura në padije nga moslërimi i gjuhës së vet "vetëm atëherë do të dalin nga gjendja e turpshme e mjerrimit të tyre, kur do të fillojnë të lëvrojnë gjuhën e tyre kombëtare". Lidhja Shqiptare e Prizrenit çështjen e mësimin të gjuhës shqipe e pati një ndër pikat kryesore të programit të saj autonomist, duke i kërkuar Portës së Lartë "të përhapet arsimit dhe në shkollat të mësohet gjuha amtare". Me gjithë ndalimin e shkrimit të shqipes prej pushtuesit dhe mallkimin e shkronjave shqipe nga kleri grek, rilindësit nuk hoqën dorë nga përpjekjet e tyre për lëvimin e gjuhës sonë dhe mësimin e saj në shkollë.

## QË SHQIPËRIA TË MOS ZHDUKEJ

Çështja e gjuhës doli në plan të parë në prag të shembjes së Perandorisë Otomane, kur atdhetarët tanë e kuptuan se i vetmi shpëtim ishte krijimi i shtetit të pavarur shqiptar. Po një shtet shqiptar nuk mund të mendohej pa një administratë shqiptare dhe pa gjuhën shqipe si gjuhë zyrtare të tij. Mirëpo mësimi i shqipes në shkollë dhe përdorimi i saj si gjuhë e administratës, në kushtet kur ajo lëvrohej me një mori alfabetesh, nuk mund të realizohej në praktikë. Mungesa e një alfabeti të përbashkët shihej "si një shenjë dashie, që pengonte bashkimin dhe kon-

solidimin kombëtar të popullit shqiptar". Nevoja e një alfabeti të përbashkët u bë urdhëruese në vitet para shpalljes së Pavarësisë. Intelektualët atdhetarë, pa u trembur nga reaksioni shtetëror e klerikal osman dhe i kishës greke, që u përpoqën t'u impononin shqiptarëve alfabetin grek ose arab, thirrën në mesin e nëntorit të vitit 1908 Kongresin e Manastirit. Klubi "Bashkimi" i Manastirit, i cili ndërmoi nismën për thirrjen e Kongresit, në thirrjen e tij shkruante, ndër të tjera, se "interesi kombëtar shtron nevojën e njësimin të alfabetit të gjuhës sonë për përparimin e popullit tonë". Që Shqipëria të mos zhdukej nën rrënojat e Perandorisë Otomane që po shembej, Kongresi i Manastirit donte t'i tregonte botës se shqiptarët, edhe pse të copëtuar në katër vilajete, kishin një gjuhë të vetme dhe me një alfabet të vetëm. Nismëtarët e thirrjes së Kongresit ishin të bindur se "alfabeti unik provon se kombi ynë është bërë një si komb". Në Kongres, të katër vilajetet shqiptare dhe shoqëritë kulturore-atdhetare të mërgatës u përfaqësuan nga intelektualët më në zë. Delegatët me të drejtë vote ishin shkrimtarë e publicistë të njohur, lëvrues të gjuhës shqipe, laikë e klerikë, veprimtarë të

lëvizjes kombëtare dhe të klubeve shqiptare. Kongresi zgjodhi komisionin e alfabetit me 11 anëtarë, me at Gergj Fishtën kryetar. Vlen të theksohet se puna e komisionit të alfabetit u karakterizua nga fryma e mirëkuptimit dhe e përgjegjshmërisë para kombit. Që në fillim anëtarët e komisionit u betuan se alfabetin që do të miratohej "do ta pranonin detyrimisht si alfabet të përbashkët për të gjithë shqiptarët". Vetë Gergj Fishta, si i deleguar i Shoqërisë "Bashkimi" të Shkodrës, deklaroi se "kam ardhur të bashkohem me ju dhe të adoptoj atë alfabet, të cilin Kongresi do ta vendosë si alfabetin më të dobishmin për ngritjen e popullit". Në të vërtetë, rruga për njësimin e alfabetit që hapur që nga Buzuku, në alfabetin prej 35 shkronjash të të cilit, siç ka vënë në dukje E. Çabej, nuk ka shkronja për zanoret hundore; alfabeti i Buzukut u përdor nga Budi dhe u përsos nga Bardhi e Bogdani. Edhe autorët e mëvonshëm që krijuan alfabetet me bazë latine, greke, arabe ose alfabetet origjinale, si dhe autorët e huaj që shkruan shqip, ashtu si autorët tanë të vjetër, iu përmbajtën parimit "për çdo zë të vetëm dhe të pandarë" një shkronjë, po të përdorim formulimin e këtij parimi nga Samiu. Kështu që

**Pa një alfabet të përbashkët dhe pa gjuhën e shkruar të njësuar, shqiptarët do të ishin ndarë të paktën në dy kombe**



numri i njësisë tingullore funksionale (fonemave) në të gjitha këto alfabetet është 36 ose vërtitet rreth kësaj shifre. Falë kësaj tradite gati 4-shkulllore, në Kongresin e Manastirit çështja e inventarit të fonemave që do të shërbente si bazë e alfabetit të përbashkët as që u shtrua fare. Diskutimet u përqendruan vetëm në atë se me ç'shkronja do të jepnin këto njësi tingullore: njëshe apo dyshe? Për shkak të mendimeve të kundërta, komisioni nuk arriti dot të miratonte një alfabet të vetëm, duke i paraqitur Kongresit dy alfabetet – një alfabet me dyshkronjësia, me bazë alfabetin e Shoqërisë "Bashkimi" të Shkodrës, dhe alfabetin me shkronja njëshe të Shoqërisë së Stambollit, që ishte më i thjeshtë, po i vështirë për të shtypur libra. Siç dihet, nga këta dy alfabetet që miratoi Kongresi, fitoi alfabeti me dyshkronjësia që përdoret sot, ndërsa alfabeti i Stambollit doli shpejt jashtë përdorimit.

## PËRMBYLLJA E FAZËS SË PARË

Duke pranuar një sistem prej 36 fonemash, që "kishte 22 fonema zanore e bashkëtingëllore më pak se shqipja dialektore", Kongresi i Manastirit zgjodhi edhe çështjen e standardizimit të "sistemit fonologjik, që

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 21 nëntor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: LIRIM DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktorë: Shkëlzen HALIMI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772



## Punon si “sirenë” dhe mbulon shpenzimet e shkollës

Një studente po financon shkollën e saj të mjekësisë duke punuar si një sirenë 'e vërtetë' dhe ajo fiton deri në 100 dollarë në orë. Yasmin Awan, e cila mban një bisht dhe noton në ujë pa ndonjë pajisje zhytëse, duke u prezantuar në pishinë dhe në festa fëmijësh për t'i argëtuar ata me pamjen e saj prej sirene. Ajo është 22 vjeç, dhe studion Mjekësinë në Universitetin e Sheffield, thotë se e do

atë punë dhe se ajo është shumë e paguar. Ajo tha: “Në fillim zbulova se mund të bëhesh një sirenë kur pashë një reklamë për kampin e sirenavë. Me të vërtetë më ka intriguar dhe mendova se mund të ishte shumë zbavitëse. Ne na mësohej zhytja e lirë, e cila është zhytja nënujore që mbështetet në aftësinë e zhytësit për të mbajtur frymën e tij, sesa në përdorimin e ndonjë pajisjeje si scuba”. Yasmin

dhe sirenat e tjera u pyetën në fund të kursit nga pronarja e këtij kursi se nëse ato dëshironin ti bashkohehin me biznesin e saj të organizimit të festave. Pastaj mermaids bleu bishtin e tyre të cilat kushtonin në mes £ 100 dhe £ 3,000 në varësi të materialit. Ajo u shprehë se e gjitha filloi si një kënaqësi, por rezultojë një mundësi e mirë biznesi nga ku ajo nxirrte të ardhurat për të vazhduar shkollën.



## NJË SHQIPTAR ZGJIDHET BERBERI MË FAMSHËM NË CHICAGO




Amerika ka qenë një ëndërr për shqiptarët, që disa prej tyre e kanë realizuar nëpërmjet lotarive amerikane. Më shumë se 200 mijë shqiptarë kanë plotësuar lotarinë me shpresën se do të fitojnë “ëndrën amerikane”. Megjithatë në rrjetet sociale ka pasur edhe debat nëse atje ku do të shkojnë, do të gjejnë parajsën. Të shumtë janë ata që thonë se do të jetë e vështirë, por të paktën nëse punon, fiton jo vetëm para, por edhe respekt. Ja një rast interesant. Një ditë më parë, në të përditshmen prestigjioze amerikane, Chicago Tribune, një shkrim i dedikohet një berberi shqiptar. Jo, nuk e kanë burgosur sepse nuk mbante kasë fiskale, por Frank Shermitraku po nderohet për punën e tij. Ai është pronar i Frank's Barber Shop në Chicago dhe

klientët ndjehen shumë të kënaqur nga puna e tij. Këtë vit, saloni i tij feston 90-vjetorin. Në fakt Shermitraku e ka blerë salonin në gusht të vitit 2006. Ajo është hapur në vitin 1926 dhe ka qenë në pronësi të Bill Docimo. Shermitraku është rritur në Korçë nën regjimin komunist. Ai thotë se ushqimi ka qenë me racione. “Familja ime e vlerëson SHBA-në më shumë se të tjerët, për shkak se ne kemi kaluar më të keqen,” thotë Shermitraku. Ai erdhi në SHBA me gruan dhe fëmijët në vitin 1994. Pasi mësoi anglisht, ai dhe e shoqja donin të bëheshin kozmetologjistë, ndaj u futën në një shkollë për kozmetikë. Saloni i tij u shërben grave, burrave, por edhe fëmijëve. Përgjithësisht klientët e tij janë burra. “Ai qeth shumë mirë dhe është një njeri i mirë”, thotë një klient. “Njerëzit duhet të të besojnë. Ne kemi avokatë, mjekë, psikologë dhe të tjera profesione që vijnë këtu”, thotë Shermitraku.

## KUJDES!

Kjo rutinë  
lë të verbër  
më shumë  
se 30 veta  
në ditë!



Smartphonat dhe tabletat janë bërë një domosdoshmëri në shoqërinë moderne, por a keni menduar ndonjëherë nëse janë të sigurt për t'u përdorur? Sipas ekspertëve, duke përdorur telefonin tuaj para se të shkoni në shtrat me dritat e ndezura mund të shkaktojë dëme serioze në sytë tuaj. Kohët e fundit, shkencëtarët kryen një studim për gratë ndërmjet moshës 22 dhe 45 vjeçare, të cilët po përjetonin një verbëri të vazhdueshme. Gratë kishin një gjë të përbashkët. Të gjitha kontrollonin rregullisht telefonin e tyre përpara se të shkonin në shtrat. Kjo çoi në përfundimin se ky zakon në dukje normal mund të dëmtojë seriozisht sytë. Arsyeja për këtë, është se syri i njeriut është mësuar me errësirën në dhomë përpara se të shkojë në shtrat. Kur vendosni dritë para fytyrës tuaj, një sy përpunon mungesën e dritës, ndërsa tjetri përpunon dritën e tepërt, e cila shkakton verbëri të përkohshme, që mund të përparojë në verbëri të përhershme me kalimin e kohës. Ekspertët rekomandojnë që të shmangni këtë zakon të rrezikshëm. Kur të jeni gati për të shkuar në shtrat, fikni telefonin, dritën dhe flini në errësirë të plotë. Ndajeni këtë informacion me këdo që njihni për të mbrojtur shikimin e tyre.

## I tha se do martohej me një tjetër, e dashura i pret organet gjenitale



Nuk pranoi që e dashuri ta braktise për tu martuar me një tjetër, në shenjë hakmarrje vajza i pret organet gjenitale. Irshad ishte takuar me të dashurën e tij në një hotel në Katipuram të Indisë, por kur ai i tha asaj se duhej të ndahej sepse së shpejti do martohej me një tjetër, mes tyre lindi një sherr i dhunshëm. Sipas asaj që raporton Metro, gruaja nuk arrinte ta pranonte idenë e braktisjes dhe për pasojë i preu organet gjenitale. Alarmi është dhënë nga klientët e hotelit, që dëgjuan britma të forta. Irshad u dërgua në spital me plagë të rënda, por mjekët mundën që t'ia shpëtonin organet pas një ndërhyrje që zgjati 8 orë. Gruaja u arrestua dhe pritet që të merret në pyetje në lidhje me atë që ka ngjarë.

## LIDHJA QË NUK FUNKSIONON KURRË

Sipas ekspertëve, lidhjet me diferencë të madhe moshe, mund të funksionojnë nëse të dyja palët janë të gatshme të bëjnë kompromise dhe të mësojnë nga njëri-tjetri. Ajo që i surprizoi autorët e këtij studimi ishte fakti se gratë që ishin martuar me meshkuj më të mëdhenj në moshë ishin shumë të pakënaqura, në krahasim me ato që kishin bashkëshortë më të rinj

Një studim 13 vjeçar ka dalë në përfundimin se bashkëshortët me diferencë të madhe në moshë kanë më pak gjasa që të kenë një martesë të lumtur. Duke përdorur punën kërkimore mbi dhjetëra çifte australiane, shkencëtarët zbuluan se çiftet që kanë diferencë të vogël në moshë janë më të sinkronizuar për vendime të rëndësishme, si koha për të pasur fëmijë dhe shpenzimet, që i bën ata që të jenë më të përshtatshëm për njëri-tjetrin për një periudhë më të gjatë. Ata dolën gjithashtu në përfundimin se burrat dhe gratë që kanë

diferencë të vogël në moshë janë më të përgatitur për të përballuar periudha krize së bashku, siç mund të jenë problemet e papritura ekonomike. Megjithatë, nga ata që u morën në vëzhgim, rezultoi se meshkujt e martuar me gra më të reja në moshë ishin më të lumtur. Nga ana tjetër meshkujt e martuar me gra më të mëdha ishin më pak të lumtur me martesën e tyre. Bashkëautorja e studimit, Dr. Terra McKinnish, i konsideroi këto të dhëna si "jo surprizuese". Ndërsa sipas ekspertit James Preece, nëse ka shumë diferencë mes palëve, ekziston rreziku që bashkëshortët të duan gjëra të ndryshme në jetë. "Për shembull, njëri dëshiron të udhëtojë, por tjetri e ka bërë më parë një gjë të tillë. Nga ana tjetër, niveli i maturisë mund të variojë në mënyrë dramatike dhe zënkat rreth xhelozisë dhe parave mund të jenë të zakonshme", tha Preece për "The Independent". Në fund, gjithçka lidhet me një lumturi të ekuilibruar. Sipas ekspertëve, lidhjet me diferencë të madhe moshe, mund të funksionojnë nëse të dyja palët janë të gatshme të bëjnë kompromise dhe të mësojnë nga njëri-tjetri. Ajo që i surprizoi autorët e këtij studimi ishte fakti se gratë që ishin martuar me meshkuj më të mëdhenj në moshë ishin shumë të pakënaqura, në krahasim me ato që kishin bashkëshortë më të rinj. Studimi tregoi gjithashtu se, si meshkujt ashtu edhe femrat, preferonin një bashkëshort më të ri në moshë. Pavarësisht kësaj, martesat ku të dyja palët ishin më afër në moshë rezultuan më të suksesshmet.

## Historia e veçantë pas kësaj fotoje



Një grua mbeti pa fjalë e me sytë e përloitur, kur mbesa e saj e surprizoi duke veshur fustanin e nusërisë që ajo kishte veshur ditën e martesës, në vitin 1962. Penny Jenson nuk ia kishte idenë që mbesa Jordyn Cleverly, e kishte fustanin e saj të vjetër, e jo më që po planifikonte që ta vishte ditën më të rëndësishme të jetës së saj. Cleverly i kërkoi fotografes Kortney Peterson që të kapte këtë moment, teksa ajo iu



shfaq gjyshes me fustanin e saj, mëngjesin e dasmës. Vetë fotografja, duke folur për amerikanen ABC News tha se ishte një ndër momentet më unike dhe më të bukura që kishte kapur ndonjëherë më parë me aparatin e saj. "Reagimi i saj ishte më i ëmbli që mund të kem parë ndonjëherë më parë. Lotët i rrodhën menjëherë nga sytë, ndërsa vijoi të përsëriste '1962... gjyshi jot do ta kishte adhuruar këtë, u




martova me dashurinë e jetës time më këtë... dhe kështu do të bësh edhe ti". 23-vjeçarja, e cila nuk e njohu kurrë gjyshin e saj, pasi ai ndërroi jetë përpara se të vinte në jetë kishte vendosur të vishte fustanin e gjyshes dy vjet para dasmës. Momentin kur doli para gjyshes, ajo e cilësoi si më shpirtërorin dhe më emocionuesin në jetën e saj.

## Sa kohë nevojitet që ilaçet të kenë efekt?



Në qoftë se jeni duke vuajtur nga dhimbje të kokës, abdominale apo diçka e tillë, mund të përdorni një paracetamol apo ibuprofen. Që nga moment kur e konsumoni ilaçin duhen të kalojnë 30 minuta që dhimbjet të lehtësohen. Kjo është kohë që stomaku ka nevojë të shpërbejë dhe të absorbojë tabletën. Ndërsa për ilaçet anti-inflamatore, siç është ibuprofen, nevojiten deri në tre javë që të merrni tërësisht përfitimet dhe të lirohni nga sëmundjet kronike. Përdorimi i ilaçeve preferohet pas ushqimit në mënyrë që të mos irritohet stomaku. Ndërsa në qoftë se dëshironi efekte më të shpejta, përdorni ilaçet në formë të lëngshme, kjo ngaqë stomaku e ka më të lehtë tretjen si dhe ngaqë veçse ilaçi është i shpërberë, do t'i ndjeni efektet më shpejtë.

# KUDO KU KA SHKELUR ÇIZMJA E MLLADIQIT, ËSHTË BËRË GJENOCID



Mlladiq akuzohet edhe për organizimin e rrethimit të Sarajevës, i cili ka zgjatur gati katër vjet. Rreth 10.000 njerëz janë vrarë në bombardime dhe nga snajperistët. Mlladiq është arrestuar në vitin 2011 në fshatin Llazarevo të Serbisë, pas 16 vjetësh në arrati. Në argumentet përfundimtare, prokurorët i kanë kërkuar gjykatës ta dënojë Mlladiqin me burgim të përjetshëm. Çdo gjë më pak do të ishte e turpshme, kanë thënë ata

Ish-të burgosur në Bosnje dhe Hercegovinë, rreth 50 sish, si dhe përfaqësues të shoqatës "Nënat e Srebrenicës dhe Zhepës" kanë shkuar në Hagë, ku të mërkurën do të marrin pjesë në shpalljen e aktgjyqimit për Ratko Mlladiqin, ish-komandant i forcave serbe të Bosnjës. Mlladiq përballet me 11 akuza, përfshirë ato për gjenocid, krime lufte dhe krime kundër njerëzimit gjatë luftës në Bosnje. Kryetari i Lidhjes së të Burgosurve, Jasmin Meshkoviq, tha për Shërbimin e Ballkanit të Radios Evropa e Lirë se shpreson se Tribunali i Hagës ka gjetur dëshmi për përgjegjësinë direkte të Mlladiqit në planifikimin dhe ekzekutimin e gjenocidit në Srebrenicë dhe për krime të tjera të luftës. Në korrik të vitit 1995, trupat e Mlladiqit kanë hyrë në qytetin e Srebrenicës, i cili ishte shpallur zonë e sigurt e Kombeve të Bashkuara, dhe kanë vrarë mbi 8.000 burra dhe djem myslimanë.

"Presim dhe duam që Ratko Mlladiq të jetë në gjendje të dëgjojë shpalljen e plotë të

**Gjatë luftës në Bosnje, që ka zgjatur nga viti 1992 deri më 1995, janë vrarë mbi 100.000 njerëz. Prokurorët në Tribunalin Ndërkombëtar për Krime në ish-Jugosllavi thonë se Mlladiq ka mbikëqyrur fushatën e vazhdueshme të spastrimit etnik kundër joserbëve në territorin e Bosnjës**



aktgjyqimit dhe provat mbi të gjitha akuzat. Ato janë përgjegjësia për gjenocidin në Srebrenicë dhe përgjegjësia për gjenocid në gjashtë komuna të tjera të Bosnjës, pastaj terrorizimi i qytetarëve të Sarajevës, mbajtja peng e forcave ndërkombëtare dhe krime të tjera kundër njerëzimit", tha Meshkoviq. "Presim të gjykohej për të gjitha akuzat dhe të marrë dënimin më të rëndë të mundshëm", shtoi ai. Në Hagë kanë udhëtuar edhe vëllezërit Sabahudin dhe Hajrudin Shehiq, të cilët kanë qendruar në kampin Vogoshqa për 150 ditë. Sabahudini tha se nuk do t'i harrojë kurrë "ditët e torturës". "Dua të marr pjesë në shpalljen e aktgjyqimit më të rëndë për Ratko Mlladiqin", tha ai. Kryetarja e Shoqatës "Nënat e Srebrenicës dhe Zhepës", Munira Subashiq, tha se pret burgim të përjetshëm për Mlladiqin. "Një aktgjykim i tillë për Mlladiqin është shumë i rëndësishëm, sepse ai është më përgjegjës për gjenocidin në Srebrenicë. Të gjithë tanët do të ishin të gjallë po të mos vinte ai dhe po të mos dë-

shironte spastrim etnik. Burgim i përjetshëm - ky do të duhej të ishte vendimi për Mlladiqin, për gjenocidin e bërë jo vetëm në Srebrenicë, por edhe në Prijedor dhe komuna të tjera. Mjafton të thuhet se kudo ku ka shkëlur çizmja e tij, është bërë gjenocid", tha Subashiq. Gjatë luftës në Bosnje, që ka zgjatur nga viti 1992 deri më 1995, janë vrarë mbi 100.000 njerëz. Prokurorët në Tribunalin Ndërkombëtar për Krime në ish-Jugosllavi thonë se Mlladiq ka mbikëqyrur fushatën e vazhdueshme të spastrimit etnik kundër joserbëve në territorin e Bosnjës. Mlladiq akuzohet edhe për organizimin e rrethimit të Sarajevës, i cili ka zgjatur gati katër vjet. Rreth 10.000 njerëz janë vrarë në bombardime dhe nga snajperistët. Mlladiq është arrestuar në vitin 2011 në fshatin Llazarevo të Serbisë, pas 16 vjetësh në arrati. Në argumentet përfundimtare, prokurorët i kanë kërkuar gjykatës ta dënojë Mlladiqin me burgim të përjetshëm. Çdo gjë më pak do të ishte e turpshme, kanë thënë ata.

## Serbia e ka humbur Kosovën në të '90-at

Udhëheqësi i Lëvizjes së Qytetarëve të Lirë në Serbi, Sasha Jankoviq, ka deklaruar sot se lëvizja e tij nuk merr pjesë në dialogun e brendshëm të Serbisë për Kosovën të cilin e vlerëson si farsë. Sipas tij, qëllimi i këtij dialogu është marrja e një vendimi të cilin presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, veçse e ka pranuar në bisedimet me përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare, raporton Tanjug. Ai mendon se Serbia e ka humbur Kosovën qysh në vitet e '90-ta dhe tani duhet përqendruar në realizimin e të drejtave të njeriut në Kosovë. Ka shtuar se duhet zgjidhur edhe çështjet e të drejtave pronësore. I pyetur që të komentojë faktin se manastiret e Graçanicës dhe të Deçanit janë renditur si trashëgimi e Kosovës, Jankoviq thotë se "është në dorën e Serbisë që të dëshmojë të kundërtën". E ndaj këtyre deklaratave ka reaguar Nënkrjetari i Bordit Kryesor të Partisë Progresive Serbe, Marko Gjuriq, i cili thotë se këto janë deklarata "skandaloze dhe të turpshme" dhe se Jankoviq, sipas Gjuriqit, nga sot është "lobues i Shqipërisë së Madhe". "Ideja që Deçani dhe Graçanica t'i lihen në dorë Prishtinës, dhe se ne duhet të dëshmojmë se janë tanët, dhe kjo del nga goja e një politikani në Beograd, ish-mbrojtës i qytetarëve dhe kandidat për president të Serbisë, është një skandal i pashembullt i përmasave të paimagjinueshme", ka thënë Gjuriq.

## Lista Serbe fituese e zgjedhjeve në Kosovë

Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë Marko Gjuriq ka thënë se Lista Serbe është fitues absolut në zgjedhjet lokale në Kosovë. Gjuriq për televizionin shtetëror të Serbisë ka thënë se komunat ku kanë fituar serbët nuk janë të vogla dhe për këtë Prishtina por edhe një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare janë përpjekur t'i përcajnë serbët. "Serbët ishin mbi të dhe e kuptuan se sa me unitet qëndron shpëtimi, e ardhmja dhe mbijetesa. Serbët në Kosovë treguan se nuk duhet të ndahen, ata mund të marrin më shumë përmes Listës Serbe dhe veprime të përbashkëta ndaj institucioneve të Prishtinës", ka thënë Gjuriq.

## Serbia po e humb edhe një Kosovë

Fshatrat serbe janë në "vdekje". Kjo ngase në madje 86 për qind të tyre numri i banorëve po zvogëlohet drastikisht, derisa rreth 1.200 janë në fazën e zhdukjes së plotë. E madhësia e tyre është e përafërt me gjithë territorin e Kosovës, është paralajmëruar të premtën në forumin "Ushqim për Evropë" në Vërdnik. "Përveç tendencës negative demografike, një prej problemeve kryesore të fshatrave të sotme është edhe gjendja jo e mirë eko-

nomike dhe fragmentimi i pasurisë, si dhe numri gjithnjë më i madh i banorëve të moshuar. Mirëpo problemet më të mëdha janë vërejtur në rajonet malore", ka thënë Dragan Shkoriq, kryetar i Këshillit për fshatra në Akademinë Serbe të Shkencave, raporton Tanjug. Duke i prezantuar të dhënat alarmuese, Shkoriq ka thënë se janë vetë fshatarët ata që po i braktisin fshatrat, ku jeteja e tyre varet prej nga puna në ara. "Për këtë arsye, tani në Serbi

ekzistojnë më shumë se 50.000 shtëpi të boshatisura dhe të paktën trefish kaq shtëpi që janë jashtë përdorimit", ka thënë akademiku Shkoriq rreth studimit të SANU-së për shkatërrimin e fshatrave serbe. Ai ka bërë të ditur se nga 4.709 vendbanime, madje 1.200 janë në fazën e zhdukjes për shkak se secili prej këtyre fshatrave ka nga më pak se 100 banorë, derisa madje 86 për qind e fshatrave po përballen me rënie e numrit të banorëve. Shër-

bime postare nuk ka në më se 2.000 fshatra, rreth 500 nuk i kanë rrugët e asfaltuara dhe janë të shkëputur nga bota derisa në 2.700 fshatra nuk ka çerdhe fëmijësh, në 230 nuk ka shkolla fillore e në 173 shkollat ekzistuese mësimet i vijnë nga vetëm një nxënës. "Potenciali i fshatrave vetëm në fushën e blegtorisë është 24 miliardë dollarë deri në vitin 2040", ka thënë Shkoriq, duke shtuar: "Serbia nuk ka përparim pa fshatra".

## Duhet zgjidhje politike për Sirinë

Vladimir Putin ka kërkuar një marrëveshje politike në Siri, gjatë një vizite të rrallë dhe të palajmëruar në Rusi të presidentit sirian Bashar al-Assad. Udhëheqësi rus nënvizoi nevojën për të gjetur një zgjidhje për konfliktin e stërzgatur civil në Siri, njoftoi Kremli. Takimi në resortin e Sochit, buzë Detit të Zi, vjen dy vite pasi Rusia nisi fushatën ushtarake në Siri në mbështetje të forcave ajrore të Assadit. Dy krerët janë takuar së fundmi në vitin 2015, pak pas ndërhyrjes ruse. Duke folur në televizionin rus, pas takimit, Putin tha se do të bisedonte me presidentin amerikan Donald Trump dhe emirin e Katarit për gjetjen e një zgjidhjeje për konfliktin. Të

mërkurën, ai do të takohet me udhëheqësit e Iranit dhe Turqisë për bisedime tripartite. "Kemi ende shumë rrugë për të bërë, para se të arrijmë një fitore të plotë mbi terroristët", tha Putin në Sochi. "Por, për sa i takon punës sonë të përbashkët në luftimin e terrorizmit në territorin e Sirisë, ky operacion ushtarak po përfundon". Assad qëndroi në tokën ruse për rreth 4 orë, tha një zëdhënës i Kremlinit. Ndërhyrja ruse në konflikt konsiderohet gjerësisht se ka kthyer zhvillimet në favor të forcave të Assadit, që janë përballë rebelëve dhe xhihadistëve, përfshirë Shtetin Islamik. Rusia është akuzuar për vrasjen e qindra civilëve sirianë në fushatën e saj ajrore, diçka që ajo vet e mohon. Assad, duke folur për televizionin shtetëror rus, pas takimit, tha se në këtë fazë, pas fitores mbi terroristët është në interesin e të gjithëve, që të ecet përpara përmes procesit politik.

## Rritet në 50 numri i viktimave nga sulmi në xhami

Numri i viktimave nga sulmi në një xhami në lindje të Nigerisë është rritur në 50, njoftoi policia. Zëdhënësi i policisë Osman Ebubekir ka thënë se ende janë duke punuar për të konfirmuar numrin e të plagosurve, pasi një numër i madh njerëzish janë shtruar në spitale të ndryshme. Sulmi është kryer në një xhami në lindje të krahinës Adamawa, në rajonin Mubi. Më tej bëhet e ditur se sulmi ndodhi në ora 5:20 sipas kohës lokale, gjatë namazit të sabahut, ndërsa është kryer nga një sulmues i ri, i moshës 17 vjeçare. Edhe pse akoma askush nuk e ka marrë përgjegjësinë mbi sulmin, supozohet se pas tij qëndron organizata terroriste Boko Haram.

## Rohani shpall fundin e ISIS-it



Presidenti i Iranit, Hassan Rohani, shpalli fundin e grupit militant Shteti Islamik, gjatë një fjalimi të transmetuar drejtpërdrejt në televizionin shtetëror iranian. "Do të doja të shpreh mirënjohjen time për luftëtarët për Islamin, diplomatët iranianë, Qeverinë iraniane dhe njerëzit e saj, liderin suprem (Ajatollah Ali Khomeini), forcat e armatosura, popullin iranian, popullin irakian, popullin sirian, popullin libanez për fundin e një grupi që nuk solli asgjë, përveç së keqe, dëmtimit, shkatërrimit, vrasjeve dhe egërsisë", tha Rohani. "Është fundi i një grupi terrorist që është ushqyer, armatosur dhe financuar nga fuqi të mëdha dhe disa vende konservatore në rajon", shtoi ai. Komandanti i Gardës Revolucionare të Iranit, gjeneral-major Qassem Soleimani, po ashtu shpalli fundin e Shtetit Islamik përmes një mesazhi dërguar udhëheqësit suprem të Republikës Islamike. Shteti Islamik ka pushtuar terrore të mëdha në Siri dhe Irak në verën e vitit 2014, por ai është luftuar në disa fronte dhe është dobësuar ndjeshëm. Garda Revolucionare e Iranit, një forcë e fuqishme ushtarake, ka luftuar në mbështetje të presidentit sirian, Bashar al-Assad, dhe qeverisë qendrore në Bagdad për disa vjet.

# MERKELI NUK MENDON TË DORËHIQET

Merkel nuk u shpreh fillimisht pas dështimit të bisedimeve paraprake për mundësinë e koalicionit mes konservatorëve, liberalëve e Të Gjellbërve të hënën (20.10). Por në mbrëmjen e së hënës ajo e bëri të qartë në dy intervista televizive, se nuk shikonte gabime në bisedimet mes CDU/CSU-së, FDP-së e Të Gjellbërve. "Kam bërë atë që mundësia, e si e thashë kishim ecur vërtet përpara". Kështu duket e logjikshme, që Merkel nuk mendon të dorëhiqet. "Jo, kjo nuk qëndron për momentin. Mendoj se Gjermania ka nevojë për stabilitet." Ajo u shpreh për ARD, se nëse Gjermania do të shkojë drejt zgjedhjeve të reja, atëherë ajo është e gatshme të drejtojë partinë e saj në një fushatë zgjedhore. Ajo është "një grua që ka përgjegjësi dhe është edhe më tej e gatshme ta marrë përsipër këtë

Si do të venë punët në Gjermani? Kjo është çështja kryesore që debatohet aktualisht në këtë vend. Kancelarja Merkel deklaroi ndërkohë se është gati për rikandidim në rastin e zgjedhjeve të reja

përgjegjësi", tha Merkel. Merkel e njohur për aftësinë e kompromisit, nuk ia doli kësaj here, as aftësia e saj e negociimit dhe as vullneti i saj për të qeverisur edhe katër vjet të tjera - FDP shpalli dështimin e bisedimeve, sepse nuk shikonte më një bazë për bisedime mes CDU, CSU e Të Gjellbërve. Por largimi i FDP-së nga bisedi-

met bëri që ndërmjetësuesit konservatorë si CDU, CSU të forconin radhët krah Merkelit, duke i dalë kundër zërave për një fund të epokës Merkel. Megjithëse nuk ka kritika nga radhët e partisë së saj, situata për Merkelin është shumë më e vështirë. Kjo është një situatë e re për vetë kancelaren, sepse në legjislaturat e mëparshme Merkel ia ka dalë pa shumë vështirësi të krijonte një qeveri të stabilizuar, dy herë me socialdemokratët dhe një herë me liberalët. Tetë javë pas zgjedhjeve parlamentare, Gjermania ende nuk ka një qeveri të re. Presidenti gjerman, Frank-Walter Steinmeier nuk është entuziast për zgjedhje të reja. "Pres nga të gjithë gatishmëri për bisedime me qëllim që të krijojmë një qeveri në një kohë të afërt", tha Steinmeier pas takimit me kancelaren Merkel.

## Persekutimi i muslimanëve është aparteid çnjerëzor

Organizata për të drejtat e njeriut Amnesty International (AI) e ka quajtur "aparteid çnjerëzor" diskriminimin dhe persekutimin afatgjat të muslimanëve të Arakanit në Mianmar. Në raportin e ri të organizatës, i cili mbledhi provat dhe intervistat dyvjeçare, tregohet në detaje mënyra e jetesës së muslimanëve Rohingya të Mianmarit ku thuhet se ata po i nënshtrohen "një sistemi të tmerrshëm të bazuar në diskriminimin e institucionizuar, i mbështetur nga shteti, i

cili arrin deri në Aparteidin çnjerëzor (sistem i diskriminimit racor)". Duke vënë në dukje se diskriminimi po përkeqësohet sidomos në 5 vitet e fundit, parashtruhet pyetja se me çfarë do të ballafaqohen kur të kthehen në shtëpitë e tyre ata të cilët kanë ikur nga operacionet ushtarake.

Në raport qëndron se qeveria e Mianmarit duhet t'u japë shtetësi dhe t'u sigurojë të drejtat tjera Rohingyave. Këtu paralajmërohet që zhvillimi ekonomik në Arakan

nuk duhet të përdoret si një mjet i cili çon më tej në diskriminim. Anna Neistat, njëra nga menaxhueset e organizatës, në raport ka potencuar se "Komuniteti ndërkombëtar duhet të zgjohet nga ky ankth dhe të përballlet me të vërtetën e asaj se çfarë po ndodh me vite në Arakan".

Neistat po ashtu thotë se komuniteti ndërkombëtar dhe donatorët duhet të jenë të sigurt se mbështetjet e tyre nuk rezultojnë me pjesëmarrje në këto shkelje.



## 60 VJET TË SHOQATËS STUDENTORE "PËRPJEKJA" NË BEOGRAD



Një grup i studentëve

# NJË VATËR E NGRITJES SË VETËDIJES KOMBËTARE

Nga Rexhep TORTE

Me Dr. Zekeria Cana në verën e vitit 1996 u takova në kafe-barin e Pallatit të Shtypit në Prishtinë. Profesorin e njihja që moti dhe me këtë rast bëra një intervistë lidhur me themelimin dhe aktivitetet e Shoqatës "Përpjekja", shoqatë kjo e studentëve shqiptarë në Universitetin e Beogradit. Këtë intervistë e kisha humbur pa dashur dhe, për fat të mirë, e gjeta ditë më parë, duke rregulluar bibliotekën shtëpiake dhe materialet e mia gazetareske. Meqë kjo intervistë përkon me 60-vjetorin e themelimit të "Përpjekjes", vendosa ta botoj në gazetën KOHA, thjeshtë që lexuesi të mund të njihen më hollësisht me hapat e kësaj shoqate.

Lidhur me themelimin dhe aktivitetet e "Përpjekjes", Shoqatë e studentëve shqiptarë në Universitetin e Beogradit, dr. Zekeria Cana deklaroi se "Përpjekja" është themeluar në Beograd më 22 nëntor 1957. Ishte e para shoqatë e studentëve shqiptarë në ish Jugosllavi dhe si shoqatë letrare, e cila u themelua në konviktin e studentëve në Beogradin e Ri, ku strehohehin 9000 studentë dhe që quhej Qyteti i Studentëve. Këtu ishin vendosur edhe shumë studentë shqiptarë, të cilët ishin shqetësuar nga politika shoviniste në Jugosllavi, e që shprehej nëpërmjet terrorit në Kosovë, aksionit tmerrues të mbledhjes së armëve, që detyroi një numër të madh të shqiptarëve

nga të gjitha trojet tona që të shpërngulen në Turqi dhe nëpër vendet tjera. Si studentë kishim si objektiv të parë që sa më shpejtë t'i kryejmë studimet e të kthehemi në Kosovë si kadro profesionale dhe e dyta, që të themelojmë një shoqatë letrare për t'u organizuar dhe vepruar në frymën kombëtare dhe politike. Fillimisht zgjodhëm Këshillin nismëtar për themelimin e kësaj shoqate. Qëllimi ynë ishte që kjo shoqatë të themelohet më 28 nëntor, në Ditën e Flamurit, por për të mos shkaktuar ndonjë provokim të panevojshëm, ramë dakord që këtë shoqatë ta themelojmë më 22 nëntor. Vendosëm që në Kryesi të marrin pjesë përfaqësues nga të gjitha fakultetet. Latif Berisha u zgjodh kryetar, Zekeria Cana, sekretar, Nahire Kabashi, arkëtare, si dhe Fatmir Agolli, Ali Aliu, Engjëll Berisha, Rifat Osmani dhe Agim Gjakova, anëtarë të Kryesisë. Pas kësaj e informuam Këshillin Universitar të Lidhjes së Studentëve të Universitetit të Beogradit. Për themelimin e "Përpjekjes" patëm një përkrahje të fuqishme të Sytki Imamit, në banesën e të cilit takoheshim vazhdimisht, pastaj përkrahjen e Mehmet Hoxhës për sigurimin e mjeteve financiare, por edhe të Fadil Hoxhës, kryetar i Këshillit Ekzekutiv të Kosovës, i cili gjithashtu na përkrahte financiarisht. Ramiz Kelmendi, redaktor i atëhershëm i "Rilindjes", ndihmoi duke bërë jehonë me botimin e informatave për themelimin e "Përpjekjes". Selia e

Lidhur me aktivitetet e UDB-ës jugosllave kundër "Përpjekjes", Zekeria Cana, tregoi se "pas demonstratave të vitit 1981 në Kosovë, edhe ndaj "Përpjekjes" filloi sërisht rrebeshi i luftës me moton kundër "Nacionalizmit dhe irredentizmit" shqiptar si edhe fushata e tërbuar antishqiptare që u shkallëzua deri në racizëm.



"Përpjekjes" ishte në Bllokun e Dytë të Qytetit të Studentëve, një dhomë e vogël me disa tavolina dhe karriqe, ndërsa Musli Mulliqi, piktor, i vendosi edhe portretet e Migjenit dhe të Esat Mekulit. Lidhur me

pagëzimin e kësaj shoqate patëm disa emra, biseduam në Seminarin e Albanologjisë dhe me Anton Çetën, ndërsa Hilmi Agani insistonte, me çka u pajtuam edhe ne të gjithë, që kjo Shoqatë të pagëzohet



• Faik Hima, Vera Gjevori dhe Rexhep Torte

"Përpjekja" i kishte rrënjët e thella, prandaj u qëndroi stoikisht erërave të forta nga të katër anët që dëshironin ta shkullnin. Ajo u forcua edhe më shumë falë punës së brezave të ardhshëm, të veprimtarëve të devotshëm që ndoqën rrugën e pararendësve të tyre

"Përpjekja". I porositem edhe vultat e shoqatës, atë të rrumbullakët dhe atë katrore, ku shkruante serbisht dhe shqip, Lidhja e Studentëve të Jugosllavisë - Shoqata letrare "Përpjekja"- Beograd. Qëllimi ynë ishte që "Përpjekja" të jetë shoqatë vatër e studentëve shqiptarë në Jugosllavi. Asokohe ishim të detyruar që lidhur me emrin "Përpjekja" të japin edhe shpjegime në qarqet universitare, sepse dikush ua kishite mbushur mendjen se përmbytja e kësaj fjale do të thotë tentativë - pokushaj, u shpreh Zekeria Cana.

Pas kësaj, vazhdoi Zekeria Cana, "siguruam pa pagesë të gjitha gazetatat dhe revistat në gjuhën shqipe që botoheshin asokohe. Kjo shoqatë nuk ishte vetëm vend ku lexoheshin tekstat e shkruara letrare shqipe, por ishte edhe një vatër për ngritjen e vetëdijes kombëtare dhe odë e ngrohtë, në të cilën mblidheshin, bisedonin, vëllazëroheshin dhe miqësoheshin studentët dhe studentet nga të gjitha viset shqiptare në Jugosllavi. Në nëntor të vitit 1957 u bë hapi i dytë strategjik dhe taktik, me guxim dhe mençuri, duke ngritur një bërthamë letrare, shoqatë letrare në Universitetin e Beogradit. Bërthama ishte grupi i vogël letrar pranë Seminarit të Albanologjisë, i themeluar nga albanologu Henrik Bariç, pas të cilit erdhën Vojislav Dançetoviç, Idriz Ajeti dhe Anton Çeta. Në sallën e mësimeve të këtij seminari organizoheshin mbrëmje







ZHVILLOHET NDESHJA E ANULUAR MES "SKOPJES" DHE FC SHKUPI

# TË VAZHDOJMË SERINË E FITOREVE

"Nuk do të jetë aspak lehtë, shkaku që do të luajmë në një terren shumë të papërshtatshëm, pa marr parasysh se të reshurat e shiut janë ndalur, prapë se prapë fusha nuk është në nivelin e duhur që ne të zhvillojmë lojën tonë. Sidoqoftë do të mundohemi të marrim tre pikë, nga fakti se arritëm fitore të dielën dhe duam që kjo seri të vazhdojë", thotë Berisha



Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 21 nëntor – Skuadra e Shkupit sot (e mërkurë) do të zhvillon ndeshjen e anuluar me "Skopjen" në stadiumin "Hekuran" në Shkup. Cekim, kjo ndeshje u desh të zhvillohet javën e kaluar, por e njëjta u anulua për shkak të terrenit të mbuluar me ujë pas reshjeve të mëdha të shiut. Tani kur janë krijuar kushte për lojë, e njëjta do të luhet sot në ora 13. Sa i përket ndeshjes, pikët u nevojiten shumë të dyja skuadrave. Nikoqiri "Skopje"

gjendet në pozitën e fundit dhe vetëm tre pikët e mbajnë në lojë për mbijetesë, derisa Shkupit pikët i nevojiten për të vazhduar qëndrimin në mesin e tabelës së klasifikimit. Fitorja e thellë ndaj Renovës ka bërë që atmosfera në kampion bardhekaltër të jetë e

shkëlqyer pas kësaj përballje, derisa në anën tjetër "Skopje" javën që lamë pas, humbi 4 me 0 nga Shkëndija në Tetovë. Shtylla e mbrojtjes së Shkupit, Sedat Berisha thotë se në lagjen 'Hekuran' shkojnë për tre pikë dhe të vazhdojnë serinë e fitoreve. "Të dielën

zhvilluam ndeshjen me Renovën, ndërsa menjëherë kemi vazhduar me punë për sfidën ndaj 'Skopjes'. Nuk do të jetë aspak lehtë, shkaku që do të luajmë në një terren shumë të papërshtatshëm, pa marr parasysh se të reshurat e shiut janë ndalur, prapë se prapë fusha nuk është në nivelin e duhur që ne të zhvillojmë lojën tonë. Sidoqoftë do të mundohemi të marrim tre pikë, nga fakti se arritëm fitore të dielën dhe duam që kjo seri të vazhdojë", deklaroi Berisha

## RENOVA-SHKËNDIJA LUHET TË SHTUNËN

**Derbi lokal i xhiros së 17-të në Ligën e Parë Futbollistike të Maqedonisë ndërmjet Renovës dhe Shkëndijës do të luhet të shtunën në stadiumin e qytetit në Tetovë, me fillim në orën 13:00. Edhe pse xhiroja e radhës është caktuar për ditën e diel, takimi në fjalë do të luhet një ditë më herët pasi skuadra nga Xhepçishti që është nikoqire e kësaj sfide, prej fillimit të këtij sezoni ndeshjet si vendase i luan ditëve të shtuna.**

## Shqiptarja nga Gostivari ndanë drejtësi në Bukuresht

Shkup, 21 nëntor – Treshja e refereve nga Maqedonia Ivana Projkovska, Vjollca Izeiri dhe Biljana Milanova do të ndajnë drejtësi në ndeshjen kualifikuese për Botërorin "Franca 2019" për futbollin e femra ndërmjet përfaqësueseve më të mira të Rumanisë dhe asaj të Moldavisë që do të zhvillohet në stadiumin "Mogosoia" në Bukuresht me 28 nëntor. Ndryshe Vjollca Izeiri vetëm para dy javëve ishte në Portugali ku ka ndaj drejtësi qytetin Viseu të Portugalisë, ku u zhvilluan ndeshjet kualifikuese për Kampionatin Evropian të futbollit për femra U-19 që do të mbahet në Zvicër në vitin 2018. Në këto gara kualifikuese në Viseu të Portugalisë morën pjesë përfaqësueset e Portugalisë, Norvegjisë, Irlandës së Veriut dhe Qipro. Kjo dëshmon shumë për autoritetin dhe cilësitë e referes nga Gostivari e cila tani është referja e vetme shqiptare që është duke ndaj drejtësi në garat ndërkombëtare.



## KF Vardar në Komisionit disiplinor

Shkup, 21 nëntor – Klubi Futbollistik Vardari nga Shkupi do të duhet ta mbushë arkën e Federatës Futbollistike të Maqedonisë, edhe atë shkaku i ndezjeve të mjeteve piroteknike të tifozëve të tyre "Komiti" në nde-

shjen ndaj KF Pelisterit. Sipas të përditshmes "Makedonski Sport", komisioni garues do të iniciojë një procedurë dhe do ta dorëzojë Vardarin në Komisionit Disiplinor për gjithçka që ka ndodhur në derbin e madh.



## Asllani, "Futbollistja e Vitit" në Suedi



Futbollistja me prejardhje nga Kosova, Kosovare Asllani, me sukseset e saja është frymëzim për çdo vajzë. Ajo është anëtare e kombëtares së Suedisë dhe luan me sukses në klubin suedez Linkopingu, e cila të hënën mbrëma u shpall "Futbollistja më e mirë e vitit në Suedi". Ky sukses i saj mahnti jo vetëm shtetin suedez, por kudo që janë shqiptarët, sepse është një sukses i jashtëzakonshëm. "Jam jashtëzakonisht krenare për këtë çmim. Ky çmimi nuk është vetëm imi po ashtu e falënderoj familjen time që qëndron pranë meje, ekipin kombëtar dhe ekipin tim", ka thënë mes të tjera Asllani.



# NUK PENDOHEM QË QËNDROVA TEK ATLETIKO

“Nuk më vjen keq që qëndrova. Ishte zgjedhja ime”, – i tha 26-vjeçari “Telefoot”. – Jam i kënaqur me zgjedhjen time, edhe pse kam shkuar në shtatë ndeshje pa shënuar. Do të kthehem”, pohon Griezmann

**Y**lli i Atletiko Madrid, Antoine Griezmann, këmbëngul se nuk ka keqardhje për vendimin e tij për të qëndruar në klubin e La Ligas. Repreruesi i Francës ishte i lidhur me një kalim te Mançester Junajtedi në fillim të këtij sezoni, por përfundoi duke qëndruar tek Atletiko për shkak të ndalimit të transferimeve të klubit spanjoll nga UEFA. Pavarësisht se ka shënuar vetëm tre gola në 14 ndeshje, në të gjitha garat e këtij edicioni, Griezmann tha se ishte ende i lumtur me



**Griezmann tani është duke u lidhur me Barcelonën, e cila fluturon lart, me 4 pikë më shumë se ndjekësi më i afërt, në krye të La Ligas. Atletiko Madrid është, gjithashtu, i pamposhtur nëpërmjet 12 ndeshjeve të kampionatit spanjoll, por gjashtë prej tyre kanë dalë në barazim, duke siguruar për momentin vendin e katërt, me 10 pikë prapa kreut**

**I pyetur nëse kishte diskutuar një lëvizje të mundshme në janar, Grizmann tha: “Jo. Diego Kosta dhe Vitolo do të vijin, kështu që ne do të përpiqemi ta mbajmë ekipin sa më lart. Këto dy përforcime do të na bëjnë mirë**

zgjedhjen e tij për të qëndruar tek Atletiko Madrid. “Nuk më vjen keq që qëndrova. Ishte zgjedhja ime”, – i tha 26-vjeçari “Telefoot”. – Jam i kënaqur me zgjedhjen time, edhe pse kam shkuar në shtatë ndeshje pa shënuar. Do të kthehem”. Grizmann tani është duke u lidhur me Barcelonën, e cila fluturon lart, me 4 pikë më shumë se ndjekësi më i afërt, në krye të La Ligas. Atletiko Madrid është, gjithashtu, i pamposhtur nëpërmjet 12 ndeshjeve të kampionatit spanjoll, por gjashtë prej tyre kanë dalë në barazim, duke siguruar për momentin vendin e katërt, me 10 pikë prapa kreut. Grizmann tha se ardhjet e Diego Kosta dhe Vitolo në janar do t'i nxisin të besuarit e Diego Simeone për më mirë. I pyetur nëse kishte diskutuar një lëvizje të mundshme në janar, Grizmann tha: “Jo. Diego Kosta dhe Vitolo do të vijin, kështu që ne do të përpiqemi ta mbajmë ekipin sa më lart. Këto dy përforcime do të na bëjnë mirë. Personalisht nuk kam diskutuar asnjë marrëveshje largimi me presidentin.”

JAJME  
SHKURT

**Guardiola mund të fitojë gjithçka te Siti si te Barça**



Legjenda e Brazilit, Ronaldinjo është i bindur se Pep Guardiola mund të përsërisë sukseset që ka arritur me Barcelonën tek Mançester Siti. Duke iu referuar ecurisë në Premier Ligë, ku Siti kryeson me 8 pikë diferencë nga Junajted dhe faktit që skuadra që drejtohet nga spanjoli e ka siguruar kalimin e grupeve në Çampions, “Ronnie” parashikon një periudhë plot suksese të “Cityzens”. “Po, Pep mund të bëjë te Mançester Siti atë që bëri te Barcelona. Si lojtar, Guardiola ka luajtur sikur të ishte trajner, pra duke menduar gjithçka në fushë. Ai ka njohuri të thella për futbollin. Sido që të jenë rezultatet, ai kupton shumë më tepër se një trajner normal. Ai e ndjen fushën e blertë”, deklaroi Ronaldinjo.

**Udineze shkarkon Delnerin**



Gjigji Delneri nuk është më trajner i Udinezes. Zyrtarizimi erdhi nga vetë klubi nëpërmjet një komunikate për shtyp. “Shoqëria ka vendosur të shkarkojë nga detyra e drejtim teknik të skuadrës së parë mister Luigji Del Nerin dhe ndihmësin e tij Gjuzeppe Ferrazzoli. Udineze falënderon Delnerin dhe Ferrazzolin për pasionin dhe dedikimin që kanë shfaqur çdo ditë në 13 muaj që kanë kaluar në bankinën tonë. U urojmë më të mirën për të ardhmen”, thuhet në komunikatën e klubit. Ndryshe, sipas mediave italiane pasuesi i Delnerit do të jetë Massimo Oddo.

## Taveçio akuzohet për ngacmim seksual!

Telashet për Karlo Taveçion nuk kanë të përfunduar. Ish-presidenti i Federatës italiane të Futbollit, “FIGC”, tani duhet të përballlet me një akuzë edhe më të rëndë, atë të ngacmimeve seksuale. Një prej drejtuesve sportive të këtij institucioni ka deklaruar se ka pasur dhunë morale dhe psikologjike nga ana e ish-kreut të qeverisë së futbollit italian, e tashmë e ka këshilluar avokatin e saj që të bëjë denoncimin në Prokurorinë e Përgjithshme. Sipas kësaj punonjëseje të Federatës, episodi ka

ndodhur në zyrën e Taveçios, ku ajo kishte shkuar për të diskutuar për çështje pune.

Sipas saj, Taveçio, duke përfutuar nga perdet e mbyllura i është afruar ndjeshëm, madje duke kryer edhe veprime të turpshme, por jo vetëm kaq. Punonjësja deklaroi se ngacmimet seksuale të Taveçios janë përsëritur dhe se ajo ka në zotërim disa video që e vetëtojnë këtë. Një histori kjo që e bën eliminimin e Italisë të duket problem më i vogël për Karlo Taveçion.



LIGA E KAMPIONËVE, GRUPI A, B, C DHE D

# JUVE ME ÇDO KUSHT KËRKON FITORE NDAJ BARCELONËS

Sonte (e mërkurë) vazhdojnë ndeshjet e Ligës së kampionëve me përballjet në Grupin A, B, C dhe D. Spitakin tre përballje, ajo në "St. Jakob Park" ndërmjes Bazelit dhe Mançester Junajtedit dhe Atletiko Madridit dhe Romës, por në qendër të vëmendjes do të jetë përballja mes Juventusit dhe Barcelonës

Juventus do të kërkojë me çdo kusht të fitojë ndaj Barcelonës sonte (e mërkurë), në ndeshjen e parafundit në grup të Ligës së kampionëve dhe është mundësia për të siguruar biletën për në turin tjetër dhe për të mos rrezikuar gjithçka në ndeshjen e fundit në grup, atë ndaj Olimpiakosit në Athinë. Bardhezinjtë në "Allianz Stadium" të Torinos luajnë vazhdimësinë, por mbi të gjitha, është mundësia për t'u hakmarrë ndaj Barcelonës që i shkaktoi një humbje të rëndë në "Camp Nou", 3-0. Disfata në Serie A nga Sampdoria thuhet se është tejkaluar në kampin bardhezi dhe vëmendja është përqendruar te sfida e sotme.

"Ne e kemi mundur tashmë Barcelonën dhe mund ta bëjmë atë përsëri. Në fakt, ne duam të bëjmë gjashtë pikë në dy ndeshjet e fundit. Ju thoni se katër ndeshjet e luajtura deri më tani nuk janë justifikuese për një ekip nënkampion Evropë. Unë ju siguroj se është e vështirë që të vish këtu dhe të fitosh 3 ose 4-0", deklaroi Miralem Pjaniç për "Gazzetta dello Sport". Derisa, edhe Masimiliano Allegri nuk është i shqetësuar pas humbjes nga Sampdoria, megjithëse pa një performancë të mirë nga skuadra e tij. "Është mëkat që humbëm sepse kemi bërë një rëndë prej performancave tona

më të mira këtë sezon. Ndeshja kundër Barcelonës do të jetë një ndeshje tjetër, jam i sigurt për këtë", deklaroi Allegri. Ndryshe, Barcelona edhe nëse humb sonte, do të kualifikohet në 1/8 e finales, derisa Juve me fitore gjithashtu do të sigurojë plasmanin në raundin tjetër. Në përballjen tjetër të Grupit D, Sportingu do të pret Olimpiakosin. Skuadra portugeze ka nevojë për një pikë në shtëpi për të garantuar së paku vendin e tretë,

ndërsa për kampionin grek është e thjeshtë: ata duhet të fitojnë, për të ngelur në luftë për pozitën e tretë. Mançester Junajtedi ka fituar të gjitha katër ndeshjet e Grupit A dhe një pikë ndaj Bazelit me të cilët përballjet sonte si mysafir, do të garantojë vendin e parë, ndërsa skuadra zvicerane mund të kualifikohet me një fitore eventuale ndaj Junajtedit. Plasmani i tyre në 1/8 e finales do të konfirmohet në rast se CSKA Moskë nuk fiton në shtëpi ndaj Benfikas.

Paris Sen-Zhermeni ka vultur progresin e grupit B nga koha e fundit dhe ka mundësinë për të fituar vendin e parë kundër Selitik, ndërsa këta të cilët tani janë të kufizuar për të synuar pozitën e tretë. Skuadra e Unai Emeri ka pikë maksimale në katër përballjet e para, ndërsa do të arrijë në pozitën e parë në rast se i fiton dy përballjet e para, ndërsa në anën tjetër Bajerni bën kiks sonte ndaj An-



Massimiliano Allegri

Është mëkat që humbëm sepse kemi bërë një rëndë prej performancave tona më të mira këtë sezon. Ndeshja kundër Barcelonës do të jetë një ndeshje tjetër, jam i sigurt për këtë

derlehtit ose PSZH në përballjen e fundit. Setiku nuk do të mund të përfundojë në dy pozitë e para, por do të mbyllin plasmanin e tyre në pozitën e tretë nëse në përballjen e fundit mundin Anderlehtin.

Atletiko Madridi ka dështuar të fitojë në katër përballjet e parë në Grupin C, ndërsa sonte djemtë e Simeones do të përballen me Romën, të cilës i nevojitet një pikë për të kaluar në fazën tjetër të Ligës së kampionëve. Në anën tjetër, Çellsit me fitore eventuale ndaj Karabakut, do të kualifikohet në 1/8 e finales.

## GRUPI A

CSKA M. – BENFIKA (18:00)  
BAZEL - MANÇESTER J.

## GRUPI B

ANDERLEHT - BAJERN M.  
PSZH - SELTIK

## GRUPI C

KARABAG – ÇELLSI (18:00)  
ATLETIKO M. – ROMA

## GRUPI D

JUVENTUS – BARCELONA  
SPORTING - OLIMPIAKOS

## Milani rrezikon përjashtimin nga kupat e Evropës

Lajmi vjen nga Spanja dhe bën që të ndizet alarmi në shtëpinë "kuqezi". Sipas "Marca"-s, është hedhur poshtë kërkesa për një marrëveshje, e prezantuar në Nion të Zvicrës nga delegacioni i Milanit para "Financial Body" të UEFA-s. Argumentet e paraqitura nga shoqëria italiane nuk i kanë bindur ekspertet e qeverisë së futbollit evropian. Milani është në pritje të vendimit të Komitetit të Disiplinës, madje të "kuqezinjtë" i frikësohen një mase të rëndë ndëshkimore, deri në përjashtim nga kupat e Evropës. Por cilat pjesë të dosjes së Milanit nuk e kanë bindur UEFA-


n? Sipas "Marca"-s, ekspertet e konsiderojnë projektin kinez të kushtëzuar nga rezultatet sportive afatshkurtra. Nuk janë të qarta madje as garancitë e prezantuar nga drejtuesit e Milanit për kalimin e pronësisë së klubit nga "Fininvest" te "Sport Investment Lux" për 740 milionë euro dhe 200 milionë euro të shpenzuara gjatë merkatos së kësaj vere. Analistët e UEFA-s e konsiderojnë këtë shpenzim të madh jashtë rregullave të "Fair play" – t financiar. Vetëm gjatë gjysmës së parë të 2017-ës, Milani është me 32 milionë euro humbje.





# SHKOLLA FILLORE "ANGELA MERKEL"

Në Gjermani ka mjaft shkolla që mbajnë emrat e ish-kancelarëve Konrad Adenauer, Ludwig Erhard apo Willy Brandt. Por kancelarja Angela Merkel, e cila ka shance të mira që pas zgjedhjeve të tetorit 2017 të jetë kancelarja më gjatë në pushtet, ia doli edhe që me emrin e saj të pagëzohet një shkollë, kur ajo është ende në post. Por kjo shkollë nuk është në Gjermani, por në Nigeri. Në kryeqytetin e Nigerisë, Niamej, shkolla fillore Goudel 2 u pagëzua me emrin "Dr. Angela Merkel", në kujtim të vizitës së saj më 10 tetor 2016. Gjatë vizitës së saj kancelarja i dhuroi shkollës "200 banka dhe pesë katedra për mësuesit", kujton drejtoresha e saj Rabi Abdoulaje. Tani drejtoresha dhe të tjerët shpresojnë për mbështetje të mëtejshme. I ngarkuari ad interim i ambasadës gjermane në Nigeri tha se Gjermania i ka dhuruar shkollës mobilje dhe materiale në vlerë prej rreth 8000 eurosh dhe se Gjermania është një nga partneret e rëndësishme të Nigerisë.



## KUNDËR MUREVE, MARTESË DYKOMBËSHE NË KUFIRIN AMERIKANO-MEKSIKAN



Dy të dashuruarit shprehën vullnetin e tyre, në prani të një gjyqtari meksikan, në "Derën e Shpresës", një pjesë e hapur nga roja kufitare amerikane, në telat që ndajnë dy vendet, për të lejuar zhvillimin e kësaj ceremonie

Një amerikan dhe një meksikane u martuan në kufirin mes dy vendeve, në formën e një manifestimi simbolik, në një çast që presidenti Donald Trump dëshiron të ngrejë një mur për të bllokuar fluksin migrator që vjen nga jugu, transmeton ATSH njoftimin e AFP-së. "Për të dashuruarit, ky mur nuk ekziston. Dashuria nuk njihet kufij", deklaroi bashkëshortja, Evelia Reyes, e veshur me një fustan të gjatë dhe një vello të bardhë. Dy të dashuruarit shprehën vullnetin e tyre, në prani të një gjy-

qtari meksikan, në "Derën e Shpresës", një pjesë e hapur nga roja kufitare amerikane, në telat që ndajnë dy vendet, për të lejuar zhvillimin e kësaj ceremonie. Ceremonia u organizua nga "Border Angels" (Engjëjt e Kufirit), një OJQ që mbron të drejtat e imigrantëve. Evelia Reyes shoqërohej nga tre fëmijët e saj të një martesë të mëparshme dhe disa të afërm dhe miq. Bashkëshortja, me origjinë nga shteti Guerrero, në jug të Meksikës, tregoi për median se "kishte njohur bashkëshortin e saj të ardhshëm,

Brian Houston para tre vitesh në Tijuana (Meksikë)". Megjithatë ajo nuk mund të hynte në SHBA sepse nuk kishte dokumentacionin e nevojshëm, një problem që mund të zgjidhet pas martesës. Ndërsa sipas "The San Diego Tribune", Brian Houston nuk mund të shkonte në Tijuana për të zhvilluar martesën për arsye që nuk janë bërë të ditura. Pjesa më e madhe e 3200 kilometrave të kufirit mes Meksikës dhe SHBA-së ndahen nga barriera të ndryshme ose tela. Presidenti Donald Trump ka premtuar gjatë fushatës së tij se do të ndërtojë një mur përgjatë këtij kufiri, duke krijuar tension në marrëdhëniet mes dy vendeve.

### Do shastiseni! Ja sa kushton riparimi i një iPhone X

Sipas disa informacioneve të reja telefoni më i shtrenjtë në botë konsiderohet iPhone X, së bashku me riparimin e pajisjes. Rregullimi i xhamit të thyer në Apple kushton diku tek 279 dollarë dhe në rast se Iphoni juaj kishte dëmtime shtesë, çmimi shkonte deri në 549 dollarë. Rregullimi i ekranit të iPhone 8 kushton 169 dollarë, derisa dëmtimet tjera mund ta rritin çmimin deri në 349 dollar. Kamera e përparme, çmimin deri në 349 dollar. Kamera e përparme, e cila përdorë teknologjinë për njohjen e fytyrës është e vendosur në ekranin e përparmë, që do të thotë se në rast të thyerjes së ekranit, së bashku me të duhet të ndërrohet edhe kamera.



KALENDARI HISTORIK 22 NËNTOR

1497 - Lundruesi portugez Vasco de Gama arrin afër Kepit të Shpresës së Mirë.

1542 - Spanja delegon "Ligje të Reja" kundër robërisë Amerikë.

1675 - Mbreti anglez Çarls II pezulton parlamentin.

1842 - Shpërthen vullkani në Malin St. Helens në Uashington.

1910 - Arthur Knight patenton boshtin e çeliktë të shkopit të golfit.

1918 - Marshal J Pilsudski bëhet kryetar i parë (diktator) i Polonisë.

1943 - Libani shpall pavarësinë nga Administrata franceze.

1972 - SHBA përfundon ndalimin 22 vjeçar të udhëtimit në Kinë.

1975 - Juan Carlos shpallet Mbret i Spanjës.

1990 - Margaret Thatcher shpall dorëheqjen e saj si Kryeministër e Britanisë së Madhe.

2005 - Angela Merkel bëhet Kancelar e parë femër e Gjermanisë.

Zjarrfikësit argjentinaz rrëzuan një mur për t'i mundësuar një gruajë që peshonte 490 kilogram të dilte nga shtëpia e saj për t'u shtruar në spital që të merrte mjekime, njoftoi të mërkurën media lokale. Kjo grua është Isabella 32 vjeç dhe jeton në Rosario, rreth 340 kilometra në veri të Buenos Aires. Ajo u nxor nga shtëpia e shtrirë në krevatin e saj që më pas u vendos mbi një kamion të mbrojtjes civile, sipas imazheve të publikuara nga e përditshmeja "Clarín". Isabella jeton duke qëndruar gjithë kohën e shtrirë prej vitesh dhe në një pjesë të madhe të trupit ajo ka humbur krejtësisht ndjenjat, ndërsa tumorë janë shfaqur në këmbët e saj për shkak të obezitetit ekstrem. "Kam qenë gjithnjë e shëndoshë. Braktisa shkollën për shkak të diskriminimeve që vuaja. Rifillova studimet për të qenë dikush në jetë. Kjo sot duket e pamundur", thotë ajo për "Clarín". Isabella peshonte 130 kile para tetë vitesh, pas vdekies së babait ajo ra në depresion.



### GRUAJA E INATOSUR

Vjen gruaja e nervozuar në shtëpi.  
- Zemër, do ta padis taksisti në gjykatë. Sot, në dy raste për pak sa nuk më vrau.  
- Mos u ngut zemër. T'i japim edhe një rast...



Marrëdhëniet njerëzore janë shpesh herë një mjerim i vërtetë, sepse pjesa më e madhe e njerëzimit nuk e kupton se, të hysh në zemrat e njerëzve nuk është një arritje, por një shans i jashtëzakonshëm.

(Marilyn Monroe)

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS